



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:
"Audit", me profile, "Auditim dhe Menaxhim Risku", "Auditim i
Institucioneve Financiare", "Kontabilitet dhe Raportim Financiar",
"Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh", "Administrim Publik"**

i

Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti Europian i Tiranës"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gentiana SHARKU

Prof. Asoc. Dr. Rezarta SHKURTI

Shtator / 2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Audit” me profile, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 684, datë 12.10.2018. Ky program mbulohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, në Fakultetin e Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i licencuar me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008 dhe i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018.

Programi Master Profesional në Audit me profile, është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit, si pjesë e sferës së financës. Përsa i përket strukturës dhe organizimit ky master është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse.

Programi i studimit realizohet me 60 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Audit” dhe ofrohet me pesë profile: a) Auditimi dhe Menaxhim Risku; b) Auditim i Institucioneve Financiare; c) Kontabilitet dhe Raportim Financiar; d) Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh; e) Administrim Publik.

Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në fushën e auditimit të brendshëm, kontrollit të brendshëm, auditimit të jashtëm, raportimit financiar, vlerësimit të projekteve dhe administrimit publik. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Programi i studimit, synon ta pajisë studentin me: koncepte të aplikuara, të specializuara; përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at; formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative; aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; njohuri teorike bazë të fushës së studimit; mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës; diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi rasti, punë praktike ose produkt profesional. Programi Master Profesional në Audit me profile është hapur në vitin 2018 dhe për vitin akademik 2018 – 2019, në këtë program janë regjistruar 42 studentë.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Në datën 01.03.2019, Universiteti European i Tiranës ka aplikuar për nisjen e procedurës së akreditimit të programit Master Profesional në "Audit" me profile nëpërmjet shërbimit në AMS. ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017" Ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UET, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge ne FEUT, Departamenti i Financës, dhe Prof. Asoc. Dr. Rezarta Shkurti, pedagoge FEUT, Departamenti i Kontabilitetit. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli.

Në datën 11.07.2019, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitave në institucion, të cilat u zhvilluan në datat 23 dhe 24 korrik në ambjentet e UET. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 25 korrik 2019.


Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit MP në "Audit" me profile. Në fund paraqiten rekomandimet për institucionin dhe kryhet një analizë SWOT mbi programin e studimit që akreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti European i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.09.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 86/10 Prot, datë 06.09.2019. Universiteti European i Tiranës përcjell pranë ASCAL më datë 16.09.2019, nëpërmjet shkresës me Nr. 67/3 Prot, datë 16.09.2019, përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në: "Audit", me profile, "Auditim dhe Menaxhim Risku", "Auditim i Institucioneve Financiare", "Kontabilitet dhe Raportim Financiar", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh", "Administrim Publik"

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë "Master profesional" në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Mbështetur në shqyrtimin e dokumentave pjesë e DVV si <i>Statutit të UET, (Ref. Nr. 2) dhe Planit Strategjik të UET 2015-2020, fq. 3 (Ref. Nr. 3)</i> , GVJ konstaton se Institucioni ka përcaktuar si vizion të tij (më poshtë citim) ofrimin e shërbimeve të edukimit të cilat nxisin rritjen e profesionalizmit, etikës qytetare dhe ndërtimin e një modeli të respektimit të kodeve të sjelljes cka kontribuon në ndërtimin e qytetarëve model dhe në konsolidimin e vlerave dhe interesave kombëtare të fushën arsimore. Pra, vizioni i UET është ofrimi i programeve të studimit që promovojnë vlerat kombëtare.
Kriteri 2. Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Sipas dokumentit <i>Statuti i UET, Neni 6, pika 6.2 (Ref. Nr. 2)</i> GVJ informohet se misioni i UET është që nëpërmjet programeve të studimit që ofron, t'u japë studentëve një edukim cilësor akademik. Gjithashtu në dokumentin <i>Plani Strategjik i UET, (Ref. Nr. 3)</i> GVJ konstaton se institucioni pohon qëllimin për të punuar vazhdimisht për thellimin e traditave më të mira universitare shqiptare. Programi i studimit MP në Audit me profile mbështetur në Statutin dhe Planin Strategjik të UET, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.
Kriteri 3. Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar <i>Statutit të UET, Neni 6, (Ref. Nr. 2)</i> GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit MP në Audit përputhet me fushën e veprimtarisë së Institucionit si edhe me qëllimet dhe misionin e tij.
Kriteri 4. Programet e studimit hartohen dhe	Referuar <i>Strategjisë së Kërkimit Shkencor UET 2017-2020, Vizioni, pika 1.1 (Ref. Nr. 3.1)</i> , GVJ informohet se vizioni i



ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Institucionit është të jetë një qendër e rëndësishme e shërbimeve të edukimit në vend dhe në rajon duke nxitur kështu edhe rritjen ekonomike. Nga vizita e GVJ në Institucion u konstatua se hapja e programit të studimit ka marrë shkas nga një projekt bashkëpunimi me disa institucione vendase dhe të huaja të rajonit, si produkt i të cilës u mendua ofrimi i një programi studimi në fushën e auditimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional si <i>Plani Strategjik 2015 – 2020, (Ref. 3)</i> , dhe <i>Statuti UET, Neni 6, pika 6.3 (Ref. Nr. 2)</i> , konstatohet nga ana e GVJ se programi i studimit MP në Audit me profile është konceptuar në harmoni me strategjitë e institucionit. Ai është konform objektivave strategjike për zhvillimin, gjithashtu, organizimi i këtij programi është bërë në përputhje me Statutin e Institucionit.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	GVJ pasi shqyrtoi drejtimit prioritar akademike të Institucionit (shkencat ekonomike, financiare, menaxheriale, jurisprudencës, shkencave politike e sociale, edukimit, teknologjisë së informacionit, komunikimit), të cilat janë të përcaktuara qartë në dokumentet e institucionit (<i>Plani Strategjik 2015-2020 - Ref. Nr. 3</i>), vlerëson se programi i studimit MP në Audit është konceptuar në linjë të zbatueshmërisë së këtyre drejtimeve prioritarë.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Dokumentet <i>MP në Audit - kurrikula e programit (Ref Nr. 14)</i> dhe <i>Plani Mësimor i MP në Audit (Ref. Nr. 14.1)</i> japin të dhëna në lidhje me strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi si edhe ndarjen e programit në profile. Nga shqyrtimi i këtyre dokumentave GVJ konstaton se ky master është i organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen	Referuar dokumenteve: <i>Planit Strategjik 2015-2020, Prioritetet në procesin mësimor, pika 4 (Ref Nr. 3) dhe Studimi për tregun</i>

e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	<i>e punës përpara hapjes së programit – (Ref. Nr. 16-16.3) si edhe diskutimeve gjatë vizitës në Institucion me pedagogët e programit të studimit, GVJ vuri re se programi ishte konceptuar bazuar në një projekt të përbashkët kërkimi në fokus të të cilit ishin nevojat e administratës publike në vend.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Referuar <i>Rregullores së programit të studimit MP në Audit, pika 3.1 (Ref. Nr. 7)</i> GVJ konstaton se për këtë program studimi specifikohen qartë objektivat për formimin e studentëve. Dhënia e dijeve dhe aftësive profesionale si edhe përcimi i formimit praktik të studentëve deri në përfundim të programit të studimit, janë në përputhje me studimet e nivelit master profesional, dhe mundësojnë që studentët të formohen konform kërkesave të tregut të punës.
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar GVJ u informua se përpara hapjes së programit MP në Audit, Institucioni ka qenë pjesë e projektit FINAC (Financial management, accounting and controlling in public administration) program i Bashkimit Europian ERASMUS +, në kuadër të të cilit është kryer edhe një studim i tregut të punës për nevojat e Administratës Publike. <i>Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit (Ref. Nr. 16-16.3).</i> Bazuar edhe në diskutimet e kryera me koordinatorin e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton megjithatë se <i>ky studim tregu nuk mbulon plotësisht programin e studimit me të gjitha profilet e tij, por vetëm një nga profilet (Administrim Publik).</i>

prishme në sektorin përkatës.	<i>Pra, studimi i tregut nuk është kryer specifikisht për profesionin e auditimit në Shqipëri dhe as nuk shtrihet përtej nevojave të administratës publike.</i>
Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit GVJ konstaton se objektivat formuese dhe struktura e programit të studimit MP në Audit orientohen kah nevojave të konstatuara në tregun e punës. (<i>Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit - Ref. Nr. 16-16.3</i>). Në përfundim të studimeve ky program u mundëson studentëve të punësohen kryesisht si auditues apo edhe konsulentë në sektorë të ndryshëm, si institucione financiare, sektori publik, etj. (<i>Rregullore e programit të studimit MP në Audit, Aneks, fq. 8, Ref. Nr. 7</i>).
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Referuar dokumentit <i>Plani Strategjik 2015-2020, Prioritetet në procesin mësimor, pika 4, (Ref. Nr. 3)</i> , GVJ konstaton se përafrimi i programeve të studimit me ato të ofruara në universitete të tjera është prioritet i Institucionit që ofron këtë program studimi. Gjithashtu, fakti që ky program studimi është produkt i një projekti shkëmbimi Erasmus+ (<i>Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit - Ref.Nr.16-16.3</i>) në të cilin janë përfshirë si universitete perëndimore ashtu edhe rajonale, sjell një përjasje konformiteti të kurrikulave të këtij programi me ato të vendeve të tjera, si edhe mundësi të larta të transferimit të studimeve.
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	Referuar dokumentacionit të DVV që lidhet me <i>Studimin e tregut të punës përpara hapjes së programit (Ref.Nr. 16-16.3)</i> , programi MP në Audit është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë. Evidenca që ofron Institucioni për përmbushjen e këtij kriteri bazohet në projektin FINAC të Erasmus +si edhe në eksperiencën disa vjeçare që ka në ofrimin e programeve të ciklit të dytë.
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	<i>Referuar Planit Strategjik 2015-2020 Vizioni, pika 7 (Ref. Nr. 3)</i> , GVJ informohet se Institucioni në vizionin e tij e vë theksin në formimin e gjykimit të shëndoshë tek studentët, duke krijuar mundësi për përvetësimin e njohurive specifike teknike e profesionale që të përgatisin për të ushtruar një profesion të caktuar. Gjithashtu, edhe rregullorja e programit të studimit thekson si një ndër objektivat kryesore të programit aftësimin profesional

	<p>të studentit - <i>Rregullore e programit të studimit MP në Audit, Neni 3.3 (Ref. Nr. 7).</i></p> <p><i>Por nuk ka evidencë që programi i studimit ka marrë në konsideratë kërkesat specifike që ka profesioni i audituesit, i cili është një profesion i rregulluar si në Shqipëri, ashtu edhe në botë. Pavarësisht mungesës së evidencës, kurrikula e Programit MP në Audit, plotëson kryesisht kërkesat e profesionit të audituesit, si profesion i rregulluar (për shkak të larmisë së profileve të këtij programi, është e pamundur përputhja e plotë me direktivat ndërkombëtare për profesionet e rregulluara).</i></p> <p>Gjithashtu, nga vizita në Institucion u konstatua fokusi që strukturat drejtuese të departamentit kishin në drejtim të përputhshmërisë sa më të plotë në të ardhmen të këtij programi me kërkesat kombëtare dhe ato ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>Aktualisht programi i studimit MP në Audit ofrohet vetëm në gjuhën shqipe. Gjithsesi nga shqyrtimi i dosjes së syllabuseve pjesë e DVV, konstatohet përdorimi i literaturës në gjuhë të huaj, si literaturë mbështetëse në shumë prej lëndëve të ofruara çka lehtëson mundësitë për shkëmbime apo edhe lejon pranimin në këtë program të studentëve të huaj në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.</p> <p>Nga ana tjetër, edhe sipas Planit Strategjik 2015-2020, UET deklaron se krijon mundësinë që për studentët Erasmus, lëndë specifike të ofrohen në gjuhë të huaj. <i>Plani Strategjik 2015-2020, Prioritetet në bashkëpunimin dhe kooperimin ndërkombëtar, pika 3, (Ref. Nr. 3).</i> Si një program i ri studimi, MP në Audit ende nuk ka pasur eksperiencë shkëmbimi me studentë të huaj, por bazuar në informacionin e marrë nga vizita në Institucion, GVJ konstaton se Institucioni ka pasur disa eksperiencë të tilla të suksesshme në të shkuarën, cka krijon precedent për përsëritjen e praktikave të tilla të mira edhe në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Mbështetur në dokumentin <i>Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit – (Ref.Nr.16-16.3)</i>, konstatohet se një ndër qëllimet e këtij programi studimi është të plotësojë nevojat e tregut të punës së administratës publike në drejtim të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe auditimit.</p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>UET është një institucion me eksperiencë mbi 13 vite, (sipas VKM Nr. 636, datë 20.9.2006 për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike "Universiteti European i Tiranës) i cili ka krijuar një traditë të nivelit të lartë të trajnimit të stafit me përvijë brenda dhe jashtë vendit. Edhe Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, që ofron këtë program studimi, ka një eksperiencë mbi 10 vite. VKM Nr. 255, datë 27.02.2008, “Për hapjen e programeve të tjera studimi pranë shkollës së lartë Universitare Private Universiteti European i Tiranës” (Ref. Nr. 54).</p> <p>Evidencat e dorëzuara dëshmojnë për cilësi të stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të njësisë kryesore dhe njësisë bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit Të dhëna tabelore për personelin akademik të njësisë kryesore dhe njësisë përgjegjëse. (Ref. Nr. 23).</p> <p>Sipas këtij dokumenti konstatohet se Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka gjithsej 48 pedagogë, nga të cilët 35 janë pedagogë efektiv (PAE) nga ku 5 kanë titullin “Profesorë”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 11 kanë gradën Dr./PhD, dhe 12 Asistent Lektorë me Msc; dhe 13 pedagogë me kontratë (PAK) nga ku 2 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 5 kanë gradën Dr./PhD. dhe 6 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Sipas informacioneve në dokumentin: Të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit – (Ref. Nr. 24) GVJ vë re se në programin e studimit MP në Audit janë angazhuar në total 14 staf akademik, 12 PAE / 2 PAK. Kualifikimi i stafit të brendshëm është: 2 me titullin “Profesorë”, 5 me titullin “Profesorë të Asociuar”, 5 me gradën Dr./PhD, dhe 2 me kualifikim të lartë në fushën e auditit -AL dhe ACCA, dhe kualifikimi i stafit me kontratë 1 me gradën Dr dhe 1 me Msc me titullin ACCA.</p>

<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MP në Audit me profile, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 kredite evropiane dhe kohëzgjatje normale 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015.</p> <p>Ky është një program i fushës së shkencave ekonomike i cili ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës. Mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është përgjegjëse për ofrimin e programit, konstatohet se ka përputhshmëri. sipas dokumentit: <i>Të dhëna për numrin e programeve të ofruara nga njësia përgjegjëse (Ref. Nr. 26)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit MP në Audit, dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës) që është përgjegjëse për ofrimin e programit, GVJ konstaton se ka përputhshmëri.</p> <p>Për dy nga profilet e ofruara (Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh dhe Administrim Publik), Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës bashkëpunon me një departament tjetër të njësisë kryesore, konkretisht me Departamentin e Menaxhimit dhe Marketingut. Për tre profilet e tjera, përputhshmëria garantohe nga fusha që mbulon Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës.</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilin të institucionit, cilësia e tij garantohe nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky është një program i fushës së shkencave ekonomike i cili ofrohet nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, pra ofrohet brenda profilit dhe ekspertizës së njësisë bazë dhe kryesore.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione,

kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentave si: <i>Rregullore e UET, Neni 16, 17, 18, 21, 22 – (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.IV-F.V.Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6); Vendim për emërimin e kordinatorëve të programeve të studimit – (Ref. Nr. 36)</i>, GVJ konstaton se ka një ndarje të detyrave dhe përgjegjësive mes strukturave të institucionit, dhe pesha kryesore për programin e studimit mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse (Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës). Shihet gjithashtu se është bërë një parashikim i detajuar dhe i kujdesshëm i rolit të përgjegjësit të njësisë bazë, përgjegjësit të grup-lëndëve dhe kordinatorit të programit sikurse dhe ato të titullarit të lëndëve specifike.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor të programit MP në Audit, institucioni ka bashkëpunuar që përpara hapjes së programit me partnerët e përfshirë në projektin FINAC, dhe se ky bashkëpunim vazhdon ende në kuadër të projektit përkatës në vijimësi. Sipas <i>Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit (Ref.Nr.16-16.3)</i>, pjesë e bashkëpunimeve në kontekstin e projektit është bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës në vend, me disa universitete europiane dhe rajonale.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Nga dokumenti <i>Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit (Ref. Nr. 32)</i> por edhe nga diskutimet me pedagogët e programit, konstatojmë se me aktorët e biznesit vendas ka disa marrëveshje bashkëpunimi kryesisht në funksion të realizimit të praktikave profesionale të studentevë të këtij programi. Duke pasur si fokus administratën publike, marrëveshje janë lidhur edhe me institucione publike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e</p>	<p>Referuar <i>Dokumentit B.I Mbi praktikën profesionale (Ref. Nr. 32.2) pjesë e Broshurës së Dokumentave</i>, GVJ konstaton se institucioni jep udhëzime të qarta për studentët për</p>

bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	modalitetet e kryerjes së praktikës dhe përzgjedhjes së vendit ku do të kryhet ajo. Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentit <i>Lista e studentëve dhe institucionet e zhvillimit të praktikës profesionale (Ref. Nr. 32.1)</i> shihet një shpërndarje e larmishme e studentëve në njësi bashkëpunimi.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Referuar evidencave 33 dhe 33.1 (<i>Të dhënat për trajnimet profesionale</i>), gjatë vitit akademik 2018 - 2019 UET është angazhuar në një sërë trajnimesh profesionale. (nëntor 2018 dhe janar 2019). Gjithashtu, edhe gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua në lidhje me trajnimet e zhvilluara me profesionistët dhe përfaqësuesit e administratës publike në Shqipëri.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Gjate shqyrtimit të dokumentacionit <i>Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Audit (Ref. Nr. 38)</i> dhe vizitës në institucion, rezultoi se Institucioni ka hartuar një raport të vlerësimit paraprak, në të cilin analizohen arritjet dhe përcaktohen objektivat për ecurinë e programit MP në Audit. Ky raport është hartuar në përfundim të semestrit të parë në kuadër të analizës së ecurisë së projektit FINAC dhe trajton elemente të pasura, por megjithatë nuk fokusohet konkretisht në analizimin e përfitimit ose jo nga marrëveshjet e bashkëpunimit dhe nëse ato kanë qënë të frytshme në funksion të realizimit të programeve të studimeve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i <i>Kurrikulës së programit MP në Audit (Ref. Nr. 14) dhe Planit Mësimor MP në Audit (Ref. Nr. 14.1)</i> , konstatohet se programi i studimit është organizuar në lëndë dhe module, të detyrueshme dhe me zgjedhje dhe të vlerësuara me kredite mësimore sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Gjithsej ky program studimi ka në total 60 ECTS dhe është i organizuar në harmoni me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015.
Kriteri 2. Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Nga shqyrtimi i <i>Kurrikulës së programit MP në Audit (Ref. Nr. 14)</i> vëmë re se ky program studimi përveçse përmban lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, ofron mundësinë që studentët që e frekuentojnë të mund të zgjedhin mes 5 profileve të ndryshme: Auditim dhe Menaxhim Risku; Auditimi i Institucioneve Financiare; Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh; Kontabilitet dhe Raportim Financiar dhe Administrim Publik.
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Nga shqyrtimi i <i>Rregullores së programit të studimit, neni 3.3 (Ref. Nr. 7)</i> por edhe nga analiza që GVJ i bëri dosjes së syllabuseve të lëndëve të programit, konstatohet se ky program studimi ofron për studentët mbulim të hollësishëm të një larmie njohurish teknike, nxit të menduarin kritik si edhe përgatit profesionistë me ndërthurje të parimeve akademike dhe njohurive praktike të disiplinës së auditimit.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Bazuar më së shumti në analizën që GVJ i bëri dosjes së syllabuseve të lëndëve të programit, por edhe në diskutimet me pedagogët dhe studentët e programit të studimit, GVJ formoi bindjen se gama e lëndëve të ofruara në këtë program studimi si edhe përmbajtja e syllabuseve të tyre mundësojnë ndërthurjen dhe integrimin e njohurive në mënyrë të tillë që, nga ana teknike, e aftësojnë studentin të përgatitet për problem zgjidhje në situata komplekse dhe e nxisin atë të reagojë duke sintetizuar informacionin e duhur në problematika të paparashikuara, në presion të kohës apo rrethanave.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet	Nga shqyrtimi i <i>Kurrikulës së programit MP në Audit (Ref. Nr. 14) dhe Planit Mësimor MP në Audit (Ref. Nr. 14.1) GVJ</i>




që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	konstaton se programi i studimit MP në Audit ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik. Studimet përmbillen me provim përfundimtar formimi, ose punim diplome. Në përfundim të studimeve lëshohet diplomë "Master profesional". Në lidhje me këto elemente ky program është i konfiguruar në përputhje me kërkesat e ligjit për arsimin e lartë Nr. 80/2015, (neni 75, pika 6).			
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Bazuar në <i>Evidencën 14.1 MP në Audit - Plani mesimor</i> , GVJ konstaton se lëndët në përmbajtje të kurrikulës së programit të studimit MP në Audit janë të organizuara sipas kategorive (A-E), në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL." Studenti merr 6 kredite në Kategorinë A, 18 kredite tek B, 18 kredite tek C, 6 në kategorinë D, dhe 12 kredite ka detyrimi përmbillës (E), i cili është provim përfundimtar formimi, ose punim diplome.			
Kriteri 7. Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar (<i>Evidenca 14.1 MP në Audit - Plani mësimor dhe dokumentit B.I. "Mbi praktikën profesionale" - Ref. Nr. 32.2</i>) GVJ konstaton se programi i studimit MP në Audit parashikon për praktikën profesionale 120 orë të zhvilluara në auditor dhe 30 orë punë individuale e pavarur e studentit, pra 150 orë pune në total që korrespondojnë me 6 kredite ECTS (1 kredit = 25 orë).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës është njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, që ofron programin e studimit MP në Audit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar verifikohet se Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit është krijuar me VKM Nr. 255, datë 27.02.2008 dhe është riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 527, datë 04.09.2018. UET është institucion i



	akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Sipas <i>Evidencës Nr. 23, Te dhena tabelore per personelin akademik te njesise kryesore dhe njesise pergjegjese</i> Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përbëhet nga 18 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 11 me grada dhe tituj. Bazuar në shqyrtimin e dokumentave të dorëzuar <i>Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2 (Ref. Nr. 6)</i> , pjesë e Broshurës së Dokumentave, GVJ konstaton se departamenti organizohet në grupe mësimore ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grup-lëndëve. Konfirmuar edhe nga diskutimet me pedagogë të programit të studimit, Departamenti zhvillon mbledhje të rregullta periodike çdo javë
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	Referuar dokumentit, <i>Personeli akademik i njesisë kryesore dhe bazë përgjegjëse (Ref. Nr. 23)</i> , vërejmë se Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës ka në përbërjen e tij gjithsej 24 personel akademik, nga ku 18 anëtarë të brendshëm (PAE), nga të cilët 3 Prof. Dr., 5 Prof. Asoc. Dr., 3 Dr. dhe 7 asistentë lektorë, dhe 6 anëtarë me kontratë (PAK), nga të cilët 3 me gradë shkencore Dr. Raporti PAE / PAK në total është 18/6 , kurse në përqindje 75% / 25% .
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Sipas <i>Evidencës Nr. 23 Te dhena tabelore per personelin akademik te njesise kryesore dhe njesise pergjegjese</i> Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës përbëhet nga 18 anëtarë të personelit akademik të brendshëm, nga të cilët 11 me grada dhe tituj. <i>Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit, pika F.V.2 (Ref. Nr. 6)</i> i cili u shqyrtua nga GVJ evidenton se Departamenti organizohet në grupe mësimore ku grupohen anëtarët e Departamentit që kontribuojnë në lëndët e përafërta, të cilat drejtohen nga Përgjegjësit e grup-lëndëve.
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Referuar dokumentit <i>B.I Mbi praktikën profesionale, pika B.I.3.1. dhe B.I.9 (Ref. 32.2)</i> , si edhe vizitës në Institucion, praktikat mësimore për programin e studimit MP në Audit mbikëqyren nga një pedagog i departamentit, i cili caktohet për të mbikëqyrur studentët nga ana formale dhe procedurale. Studentët ndiqen gjithashtu edhe nga personi përgjegjës në insitucionin ku zhvillohet praktika me të cilin ruhen kontakte

	<p>të vazhdueshme.</p> <p>Praktika profesionale në kuadër të programit të studimit zhvillohet për 120 orë në auditor, ose 3 javë. (bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në Institucion u kuptua se praktika mësimore realisht kryhet pranë institucioneve në përputhje me profilin e studentëve dhe jo në auditor sikurse specifikon Plani Mësimor i Programit.) Studentët të cilët janë të punësuar kanë mundësi që praktikën ta zhvillojnë pranë institucionit ku punojnë, sigurisht duke u sugjeruar, që nëse kanë mundësi të aktivizohen edhe në pozicione pune të reja.</p>			
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Si pjesë e DVV, GVJ u njoh edhe me dokumentin <i>Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit (Ref. Nr. 36)</i>. Me vendimin Nr. 93, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit për këtë program studimi është caktuar koordinatori. Detyrat kryesore të koordinatorit përcaktohen në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit, si edhe në aktet rregullatore të UET. Koordinatori i programit të studimit luan një rol të rëndësishëm dhe aktiv në ecurinë e programit, cka u konfirmua edhe nga diskutimet e bëra me koordinatorin e këtij programi gjatës vizitës në Institucion.</p>			
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësise përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.</p>	<p>Nga diskutimet e bëra me koordinatorin e këtij programi gjatës vizitës në Institucion, GVJ konstaton se mes koordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesit të departamentit të Ekonomiksit dhe Financës, ka një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe që ndihmonte të dyja palët në vendimmarrje të përditshme.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për</p>	<p>Bazuar në diskutimet e kryera me pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se në përgjithësi informacionet për elementet e rëndësishme të programeve të studimeve janë publike dhe të mundshme për</p>

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>t'u aksesuar lirisht. Tërësia e të dhënave gjendet në Broshurën e Dokumenteve të UET ku çdo anëtar i personelit akademik kishte akses. Për çdo përditësim të rregulloreve apo kërkesave në fuqi, anëtarët e personelit pranuan se u nënshtrohen seancave të informimit nga strukturat përkatëse të UET. Studentët e programit të studimit e marrin informacionin e nevojshëm në platformën LMS. <i>Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS (Ref. Nr. 46.1).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e <i>Kurrikulës së programit (Ref. Nr. 14) dhe Rregullores së programit, pika 3 (Ref. Nr. 7)</i> GVJ konstaton se programi i studimit MP në Audit është i organizuar në module të detyrueshme dhe me zgjedhje, praktikë e aktivitete formuese sipas kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Mbështetur në <i>Planin mësimor të programit (Ref. Nr. 14.1)</i> programi i studimit MP në Audit është i organizuar në lëndë që vlerësohen në kredite ECTS (çdo lëndë është 6 kredite; 4 lëndë të detyrueshme dhe 3 lëndë me zgjedhje që përcaktojnë profilin). Programi është i ndarë në dy semestra me 30 kredite secili dhe zgjat një vit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i <i>Planit mësimor të programit (Ref. Nr. 14.1)</i> MP në Audit, GVJ konstatoi se ky dokument jep informacion në lidhje me ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Përsa i përket elementeve të tjera: frekuentimi /ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve, vërejmë se Institucioni i specifikon ato në rregulloren e UET dhe rregulloren e programit të studimit. Rregullat për nivelin e frekuentimit të mësimit (80%) në rastin e programeve të ciklit të dytë (<i>Rregullorja e programit, pika 5 dhe 6 (Ref. Nr. 7).</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi <i>Rregulloren e programit të studimit, pikat 2 dhe 9 (Ref. Nr. 7)</i> konstatoi se ky dokument përmban detajet e nevojshme të kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësohen për t'u pranuar në programin e studimit. Kjo rregullore përcakton edhe procedurat dhe kriteret për transferimin e studimeve, të cilat trajtohen në një nivel më të lartë (rang institucioni) edhe në dokumentin D.II të Broshurës së Dokumenteve. <i>Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve (Ref. Nr. 28)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar dhe më konkretisht nga dosja e syllabuseve, GVJ konstatoi se në përgjithësi në syllabusin e çdo lënde të programit të studimit</p>

<p>e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>MP në Audit paraqitet informacion i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit. Cdo syllabus ndërtohet bazuar në një format të gjithëpranuar. Mbështetur në <i>dokumentin A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe përdorimit të literaturës (Ref. Nr. 39)</i> por edhe në konfirmimet e marra nga vizita në Institucion, syllabusët miratohen përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe përgjegjësi i departamentit. Sipas evidencës 37 - <i>Shembull relacioni për vlerësimin e përputhshmerisë së syllabuseve</i>, por edhe nga konfirmimet gjatë vizitës në Institucion syllabusët i nënshtrohen edhe shqyrtimit të tyre nga KSBC përse i përket përputhshmërisë me formatin e detyruar.</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit të studimit, GVJ konstatoi se programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program dhe kreditet për secilën prej tyre parashikohet se duhet të rishikohen në mënyrë periodike. (Rishikimi bëhet në konsultim me Bordet e Tregut të Punës si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës). <i>Rregullorja e programit të studimit (Ref. Nr. 7)</i>. Ky program studimi është i ri, në vitin e parë të realizimit të tij, por nga ana e drejtuesve të Institucionit, gjatë vizitës, GVJ konstatoi angazhim dhe gatishmërinë për rishikimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit, si edhe mendje të hapur kundrejt sugjerimeve për të shtuar elementë të cilët rrisin vlerën e programit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.4</p> <p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Ligji Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, neni 75, pika 6 përcakton se programet profesionale organizohen me 60 ose 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit ose dy vite akademike. GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit në MP në Audit realizohet</p>

	me 60 kredite dhe me kohëzgjatje normale 1 vit akademik.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Meqënëse nga shqyrtimi i dokumentacionit nga GVJ u konstatua se hyrja në këtë program është e hapur edhe për studentë të cilët nuk kanë domosdoshmërisht formim të mëparshëm në shkencë ekonomike (pra mund të mos kenë një diplomë bachelor në ekonomi), programi parashikon edhe lëndë të formimit të nevojshëm profesional (p.sh., Kontabiliteti Financiar). Përmbajtja e përgjithshme e moduleve dhe transmetimi i njohurive lehtësojnë formimin teorik dhe praktik të studentëve në funksion të punësimit të tyre.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimin profesional.	Nga shqyrtimi i <i>Planit mësimor i programit (Ref. Nr. 14.1)</i> GVJ konstaton se në semestrin e parë të programit MP në Audit zhvillohen 4 lëndë gjithsej (3 lëndë të detyrueshme dhe 1 lëndë me zgjedhje). Tre lëndë zhvillohen në semestrin e dytë (1 lëndë e detyrueshme dhe 2 lëndë me zgjedhje). Gjatë semestrit të dytë zhvillohet edhe praktika mësimore. Ndërsa Tema e Diplomës ose provimi përfundimtar i formimit fillojnë të trajtohen që në semestrin e parë (10 orë në auditor) e vazhdojnë semestrin e dytë (14 orë në auditor). Shpërndarja e ngarkesës mësimore në dy semestrat është e balancuar dhe lë hapësira për kombinim e duhur teoriko-praktik.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga shqyrtimi i <i>Kurrikulës së programit (Ref. Nr. 14)</i> GVJ konstaton se programi i studimit është organizuar në pesë profile mësimore. Struktura e programit përbëhet nga 4 lëndë të detyrueshme (tre zhvillohen në semestrin e parë dhe një në semestrin e dytë), pjesë e të cilave janë lëndë karakterizuese të programit (kategoria B), si “Auditimi Financiar”, “Analiza dhe Raportimi Financiar” dhe “Kontabiliteti Financiar”, të nevojshme këto për këtë program studimi, por edhe lëndë bazë, “Metoda Kërkimi të Avancuara”, <i>lëndë e cila konstatohet se nuk është lënda më e rëndësishme bazë për këtë program studimi. Duke qenë program studimi Master Profesional, mund të sugjerohet ndonjë lëndë tjetër e formimit bazë që mund t’u vlejë më shumë studentëve që do të ushtrojnë këtë profesion në praktikë.</i> <i>Gjithashtu, nga një analizë e përmbajtjes së njohurive brenda profileve, konstatohet se profili “Auditim dhe Menaxhim Risku” ka të nevojshëm pasurimin e syllabuseve të lëndëve, ose pasurimin e vetë lëndëve të ofruara me qëllim reflektimin më të mirë të emërimit të profilit.</i>

<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor të programit (Ref. Nr. 14.1) GVJ konstaton se ky program studimi ofron mundësi praktike të disiplinës së auditimit duke afruar në auditor ekspertë të fushës për leksione dhe orientime praktike si edhe duke mundësuar praktikën pranë vendeve të punës dhe në Institucione të tjera. Personeli akademik i angazhuar gjithashtu karakterizohet nga një nivel i lartë specializimi në praktikë (ACCA dhe AL në përbërje të stafit). Gjithashtu konstatohet se ka lëndë të reja të ofruara me orientim të theksuar praktik (si p.sh., Vlerësim Ekonomik Projektsh – Profili Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Sipas Broshurës së Dokumenteve të UET, <i>Dokumenti A.III, pika A.III.12.2.</i> (Ref. Nr. 39), Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, si cdo departament i UET duhet të përditësojë në mënyrë periodike literaturën bazë dhe të detyrueshme të programit të studimit me qasjen që literatura bazë të jetë publikim i një prej shtëpive botuese prestigjioze ndërkombëtare dhe të datojë jo më e vjetër se 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i bërë për syllabuset, konstatohet që ky kriter përmbushet kryesisht, me përjashtime të vogla nga e cila buron edhe përdorimi i terminologjisë të vjetëruar në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Sugjerojmë përditësimin e këtyre teksteve¹.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri Dosjes së Syllabuseve të programit MP në Audit, përmbajtja e tyre në përgjithësi mundëson kryesisht përfitim të dijeve dhe aftësive nga ana e studentëve të kompetencave teknike të synuara për një program të masterit profesional. Përsa i përket aftësive teknike në profesion, syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi paraqiten kryesisht të kompletuara, me disa përjashtime që nuk çenojnë vlerën totale të përmbajtjes së programit (shiko kriteri 4 më lart).</p>
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Bazuar në analizën që GVJ i bëri Dosjes së Syllabuseve të programit MP në Audit, në vija të përgjithshme organizimi i programit të studimit siguron kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Por, në elemente të veçanta, programi ka nevojë të pasurohet në përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve që ofron, me fusha dhe tematika të cilat konsiderohen të</p>

¹ Teksti i Kontabilitetit financiar është më i vjetër se pesë vite. Përdoren ende terma si Bilanc Kontabël, PASH etj, në një kohë që SKK të përmirësuara të vitit 2016 kanë një tjetër terminologji.

	<p>rëndësishme për përfitim të kompetencave profesionale të audituesve si profesion i rregulluar në vend dhe në botë. Kështu, në përputhje edhe me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IES 4 dhe IES 7, IAESB/IFAC).</p> <p><i>Sugjerojmë përfshirjen e lëndëve ose të temave që mbulojnë çështje që kanë të bëjnë me etikën në profesion, vlerat morale dhe qëndrimet profesionale të audituesve.</i></p> <p>Këto elemente (përveç njohurive dhe aftësive teknike) konsiderohen tejet të rëndësishme për profesionistët e fushës së auditimit, sidomos në profilet e Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Auditimit të Institucioneve Financiare dhe Kontabilitetit e Raportimit Financiar. Sigurisht këto kompetenca profesionale, vlera, etika dhe qëndrime janë me vlerë jo vetëm për audituesit e jashtëm, po edhe për ata të brendshëm, jo vetëm për audituesit e sektorit publik, por edhe të sektorit privat dhe institucioneve financiare dhe bankare.</p>								
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit MP në Audit (Ref. Nr. 7), studenti mund të transferojë studimet në një program Master i Shkencave në fushën e financës, nëse do të ishte i interesuar të vazhdonte thellimin e njohurive në fushën akademike.</p> <p>Megjithatë, përmbajtja e programit të studimit MP në Audit, konstatohet se mundëson kryesisht punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës por pa j'ua hequr të drejtën që u jep ligji.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="574 1411 766 1512">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="766 1411 973 1512">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="973 1411 1189 1512">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 1411 1402 1512">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="574 1512 766 1574"></td> <td data-bbox="766 1512 973 1574"></td> <td data-bbox="973 1512 1189 1574" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1189 1512 1402 1574"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të</p>	<p>Nga shqyrtimi i <i>Të dhënave tabelore për personelin akademik të programit të studimit (Ref. Nr. 24)</i> GVJ konstaton se ka një</p>

<p>pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>shpërndarje të mirë mes personelit akademik efektiv dhe atij me kontratë. Për këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie gjithsej 14 anëtarë të personelit akademik, nga ku 12 personel akademik me kohë të plotë(PAE), ku 11 prej tyre janë me tituj/grada dhe 2 personel akademik me kohë të pjesshme(PAK). Pra raporti PAE/PAK për këtë program studimi është 12/2.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i <i>Të dhënave tabelore për personelin akademik të programit të studimit (Ref. Nr. 24)</i> si edhe nga analiza e <i>CV të personelit (Ref. Nr. 20)</i> GVJ konstaton se personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit karakterizohet nga një shpërndarje e ekuilibruar sipas titujve akademikë dhe gradave shkencore. Kështu nga 12 personel akademik efektiv, 2 kanë titullin Prof. Dr., 5 Prof. Asoc. Dr., 4 Dr. dhe 1 anëtar me statusin e Audituesit Ligjor. Personeli me kohë të pjesshme përbëhet nga 1 Dr. dhe një anëtar me kualifikimin ACCA.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Nga analiza e <i>Te dhënave me ngarkesën e plote mesimore të stafit akademik të programit (Ref. Nr. 25)</i> dhe e <i>CV të personelit (Ref. Nr. 20)</i>, GVJ konstaton se pedagogët që janë të angazhuar në lëndë të këtij programi mësimor kanë formimin e duhur por edhe përvojën për të dhënë mësim në ato lëndë të cilat u janë ngarkuar. Sipas <i>Dokumentit G.II. Mbi parimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore (Ref. nr. 11)</i> rregulli i Institucionit është që anëtari më i kualifikuar i personelit akademik mbulon lëndën/lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit përkatës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadrin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, GVJ gjatë shqyrtimit të DVV por edhe gjatë vizitës në Institucion morri informacion për programin 500+, i cili është ende në proces. Synimi i këtij programi është formalizimi i bashkëpunimit me aktorët kryesorë të biznesit në vend me fokus kryerjen e praktikave pranë këtyre biznesve por edhe përfshirjen e drejtuesve të këtyre kompanive në leksione të hapura. Nga takimet në Institucion përfaqësues të këtij të fundit u shpeshën për GVJ se gjatë periudhës Tetor – Maj 2019 nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës janë zhvilluar rreth 11 leksione të hapura. Nga raporti paraprak i vlerësimit të programit të studimit, (<i>Evidenca 38 - Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP në Audit</i>) GVJ vëren se këto elemente vlerësohen maksimalisht nga studentët, por pavarësisht sa ka bërë Institucioni në këtë drejtim ende</p>

	konsiderohen të pamjaftueshme, pra studentët kërkojnë shtimin e numrit të lektorëve të ftuar dhe përfshirjen edhe më të shumtë të përfaqësuesve të biznesit dhe kompanive.			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Sipas RVB (standardi II.5, kriteri 5) të dorëzuar nga Institucioni dhe mbështetur edhe në <i>Planin Mësimor të Programit të Studimit (Ref. Nr. 14)</i> , për këtë program studimi (MP në Audit) nuk parashikohen orë laboratorike. Megjithatë, në nivel njësie kryesore dhe institucioni ekzistojnë struktura përgjegjëse (Drejtoria e IT) që merren me mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve, dhe sigurojnë mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera për zhvillimin e praktikës mësimore nëse kjo do të ishte e nevojshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Mbështetur në shqyrtimin e <i>Statutit të UET (Ref. nr. 2)</i> , dhe konfirmuar nga vizita në Institucion, GVJ konstaton funksionimin në Institucion të Bordeve të Tregut të Punës. Në përbërje të këtyre Bordeve janë përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve ose të profesioneve respektive, shpesh herë edhe ish Alumni të suksesshëm të Institucionit. Me këto Borde, përveç aktiviteteve të tjera të parashikuara, organizohen takime në fillim dhe në fund semestri për të marrë sugjerime për përmirësimin e përmbajtjes së kurrikulave.
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV konstaton se përfshirja dhe përfaqësimi i studentëve dhe strukturave të tyre me anëtarë në Senatin Akademik, Këshill i Etikës, KSBC është i parashikuar në <i>Statutin e UET Neni 16, 18.4, 19.2.4, 19.6.2, (Ref. Nr. 2)</i> ; Gjithashtu, përfshirja e studentëve është edhe pjesë e prioritetëve në qendër të Planit Strategjik 2015-2020 të Institucionit sipas dokumentit <i>Plani Strategjik, fq. 5</i>

përmirësimit të programit të studimit.	(Ref. Nr. 3). Nga ana tjetër, gjatë takimeve me përfaqësues të Institucionit u konfirmua një fakt i hasur edhe në dokumentin <i>Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e departamentit. F.V.2.3. (Ref. Nr. 6)</i> , pra që një herë në muaj, Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës i cili ofron këtë program studimi zhvillon mbledhje të hapura për studentët e programeve të tij, me qëllim që ata të kenë mundësi të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit por edhe për problematika të tjera të hasura.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Programi specifik i studimit, MP në Audit është ende në vitin e parë dhe nuk ka ende student të diplomuar, por në nivel njësie kryesore dhe bazë, nga takimet me përfaqësues të Institucionit, GVJ vëren një fokus të qartë në mbajtjen e lidhjeve me studentët e diplomuar Alumni. Përfshirja e tyre ishte jo vetëm në Bordet e Tregut të Punës, nëpërmjet të cilave vjel opinionet e këtyre ish studentëve për përmirësimin e programeve të studimit, por edhe në shumë evente të tjera të cilat kanë karakter marketingu, por edhe pasurimi të jetës në fakultet.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se ky program studimi ishte produkt i një projekti bashkëpunimi me një rrjet të gjerë ndërkombëtar dhe rajonal Institucionesh partnere (projekti FINAC). Partner vendas në projektin FINAC është Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Në përputhje me gjetjet e studimit të kryer në kuadrin e këtij projekti, UET deklaroi se ka formuluar edhe përmbajtjen e këtij programi studimi i cili është në vitin e parë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, konkretisht dokumentave <i>Dok. A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref. Nr. 39); Rregullore UET, Kreu V (Ref. Nr. 5)</i>, GVJ konstaton se Institucioni ka udhëzues mbi parimet e hartimit të syllabuseve dhe metodave të mësimdhënies dhe ia vë në dispozicion këto orientime personelit akademik. Gjithashtu, GVJ konstaton se UET ka organizuar trajnime të personelit akademik të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe në kuadër të angazhimit në veprimtari kërkimore shkencore, por edhe në përdorimin e sistemit informatik LMS (<i>Ref 43.1. Trajnim mbi sistemin UET LMS</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi nga ana e GVJ i dokumenteve në DVV, (<i>Rregullore e UET, Neni 22 - Ref. Nr. 5</i>), u konstatua se UET ka implementuar mekanizma monitorimi dhe vlerësimi të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik. konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, bëhet nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndës; 2. Vlerësimi i pedagogut dhe i lëndës nga studentët kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimin e tyre, vlerësimi përmes focus-grupeve me studentët, si dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; 3. Vetvlerësimi; 4. Rezultatet e raporteve të KSBC –së; 5. Vlerësimi nga KVP i cili ngrihet nga Rektori; 6. Zhvillimi i leksioneve të hapura;
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave</p>	<p>Mbështetur në <i>Rregulloren e UET, Neni 22 – (Ref. Nr. 5)</i>, dhe në diskutimet me përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës, GVJ konstaton përfshirjen e studentëve në vlerësimin</p>

<p>e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>periodik të formave e metodave të mësimdhënies. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet pyetësorëve me frekuencë semestrale dhe përpara zhvillimit të provimit. <i>Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. 40).</i></p> <p>Gjithashtu nga rregullorja e provimeve në UET shohim se është parashikuar edhe mënyra e trajtimit të ankimit nga ana e studentëve për komponentët e vlerësimit. Mbështetur në nenin 32 të Rregullores së UET për ankesat individuale për vlerësimin e marrë, studenti ka mundësinë t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit. <i>(Ref. Nr. 40.1 D-VI-3-3 Formular per ankesat e studenteve Departamenti).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, <i>Ref. Nr. 38. Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Audit</i>, GVJ konstaton se strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie (në këtë rast KSBC) pasi përpunojnë rezultatet e vlerësimit ia komunikon ato autoriteteve drejtuese të UET. Anëtarëve të personelit akademik iu komunikohen gjetjet nga Përgjegjësi i Departamentit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga diktatimet e kryera gjatë vizitës në institucion me anëtarë të personelit akademik dhe GVJ-së, u konstatua se trajtimi i problematikave të evidentuara nga vlerësimi dhe rezultatet e marra varion që nga zhvillimi i seminareve trajnuese për promovimin e praktikave më të mira të mësimdhënies dhe deri tek masat konkrete për pedagogët të cilët kanë shfaqur problematikë të vazhdueshme (mos rinovim i kontratës për vitin akademik të ardhshëm për një rast të vetëm i cili nuk lidhet me programin MP në Audit).</p> <p>Në asnjë rast problematikat nuk kanë qenë aq të rënda, sa për t'i trajtuar nëpërmjet Këshillit të Etikës, raportohet nga drejtuesit e njësive bazë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Format e</p>	<p>Nga shqyrtimi i <i>Dokumentit A.III. Mbi parimet e ndërtimit të</i></p>

<p>mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p><i>programit të lëndës, pika A.III.3 (Ref. Nr. 39),</i> GVJ konstatoi se si rregull i përgjithshëm UET aplikon si forma mësimdhënie leksionet, seminarët, detyrat e kursit, esetë, projektet, praktikat profesionale dhe orët e hapura me lektorë të ftuar; punim diplome ose provim të përgjithshëm formimi. Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të Programit të Studimit (<i>Ref. Nr. 14</i>), si edhe e dosjes së syllabueseve, GVJ konstaton se format e mësimdhënies për këtë program specifik janë leksionet, seminarët, detyrat e kursit/esetë, praktikat profesionale dhe orët e hapura me lektorë të ftuar të fushës së auditimit.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ-së në Institucion, personeli u shpreh i nxitur pozitivisht nga interesi dhe niveli i lartë që kanë demonstruar studentët e MP në Audit gjatë këtij viti të parë të funksionimit të tij. Personeli akademik pranon se angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. Në bazë të fushës dhe natyrës së programit të studimit si dhe feedback-ut të marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, përveç atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi në grup për të nxitur bashkëpunimin mes palëve në kushte simuluese të punës etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Nga diskutimet me përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës, GVJ formoi bindjen se UET e nxiti personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike duke siguruar programe trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. (U referua gjithashtu që UET organizon në mënyrë periodike Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet dhe metodologjinë). Gjithashtu në fillim të vitit akademik, Universiteti organizon edhe trajnimin “Back to work”. Bazuar edhe në <i>Të dhënat për shkëmbimin e stafit (Ref. Nr. 43.3)</i> GVJ konstaton se personeli akademik ka mundësi jo të pakta që të përfitojë edhe nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të</p>	<p>Nga shqyrtimi i <i>Dosjes së syllabuseve (Ref. Nr. 1-16) dhe CV të personelit</i>, GVJ formoi opinionin se personeli akademik i angazhuar në programin MP në Audit, paraqitet i kompletuar jo vetëm me tituj dhe grada por edhe me formim profesional</p>




mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	në këtë fushë pasi një pjesë zotërojnë kualifikime/certifikata kombëtare dhe ndërkombëtare (ACCA/AL), por edhe kanë pasur eksperiencë të mëparshme profesionale në shërbime publike në administratë. Personeli akademik gjatë vizitës në Institucion theksoi se në leksione/seminare përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies, duke kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore.			
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Sipas informacioneve të marra gjatë vizitës në Institucion si edhe nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstaton se në cdo fillim viti akademik, UET rishikon syllabuset e lëndëve, pjesë e së cilave janë edhe format dhe metodat e mësimdhënies. Në këtë proces reflektohen rezultatet e vlerësimit të kryer me studentët dhe merren masat përkatëse. Këto masa variojnë që nga ndryshime në programin e një lënde të caktuar, me ndryshime të përmbajtjes së kurrikulës së programit, dhe deri në ndryshim të personelit akademik që zhvillon lëndën nëse konstatohet se pedagogu nuk ka kompetencën dhe aftësitë e duhur për të vijuar angazhimin (një rast i konstatuar, jashtë programit mësimor MP në Audit).			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Nga diskutimet me përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës, GVJ formoi bindjen se personeli akademik përdor realisht metoda të ndryshme për të garantuar angazhimin e studentëve në procesin mësimor. Personeli u shpreh i motivuar nga shkalla e përkushtimit të studentëve cka tregon se orët e mësimin janë tërheqëse për ta.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Nga diskutimet me përfaqësues të personelit akademik të programit gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se ata ishin të angazhuar për të nxitur bashkëpunimin mes studentëve përmes formave të tilla si detyrat e kursit që në programet master zhvillohen përmes prezantimeve në grup; ofrimin e lëndëve në klasa të përziera me studentë nga programe të ndryshme studimi, cka kultivon mendjen e hapur të studentëve dhe nxit shqyrtimin e problematikave nën këndvështrime të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin

profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Bazuar në dokumentin <i>Infrastruktura në funksion të zhvillimit të programit (Ref. Nr. 42) plus edhe në konstatime gjatë vizitës në Institucion</i>. GVJ konstaton se Institucioni garanton hapësira dhe infrastrukturë të mjaftueshme dhe të mirëmbajtur që mundësojnë kryerjen në mënyrë dinjitoze të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se në ambientet e Universitetit funksionon rrjeti wireless për studentët dhe se sallat mësimore ishin të pajisura me mjetet e duhura audio-vizive që garantojnë një proces mësimor të kompletuar me të gjitha format e premtuara të mësimdhënies. Studentëve u jepej akses në sistemin e brendshëm UMS, për sa kohë që gjenden në ambientet e Institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Bzuar në shqyrtimin e DVV, si <i>Të dhënat mbi platformën Learning Management System, LMS (Ref. Nr. 46.1, 46.2, 46.3)</i>, GVJ konstaton se UET përdor sistemin MOODLE (UET LMS) që lidh studentin dhe pedagogun dhe azhuron në kohë reale materialet e hedhura në këtë platformë nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Kjo platformë hapet në fillim të semestrit dhe mbyllet në fund të tij. Për studentët që regjistrohen në provime gjatë sezoneve ripërsëritëse, sistemi funksionon në bazë të regjistrimeve të bëra. Nga vizita në Institucion dhe diskutimet me personelin akademik u konstatua përdorim në masë të gjerë i kësaj platforme (pedagogët u shprehën se tashmë nuk mund ta mendojnë kryerjen e procesit mësimor pa një platformë të tillë komunikimi interaktiv pedagog-student).</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, mbështetur në shqyrtimin e DVV (<i>Fondi i Bibliotekës për fushën shkenca ekonomike - Ref. Nr. 45</i>); <i>Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë - Ref. Nr. 45.1</i>; <i>Plani Mësimor i Programit të studimit – Ref 14</i>; <i>Syllabuset e lëndëve Ref. Nr. 1-16</i>), konstatoi se titujt e përfshirë në literaturën bazë dhe ndihmëse të këtij programi përmbushin objektivat e studimit të tij dhe u mundësojnë studentëve të marrin njohuritë e nevojshme të parashikuara në program.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në Institucion në ambientet e bibliotekës konstatohet <i>mungesë e titujve dhe botimeve të fushës së Auditimit</i>.</p>



<p>të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p><i>Kjo nuk përkon me gjetjet e vlerësimit paraprak të ecurisë së programit (Evidenca 38: Raporti paraprak i vlerësimit të programit MP Audit.)</i> Mungesa në Bibliotekë e titujve në fushën e auditimit u pranua nga drejtuesi i njësisë bazë dhe u argumentua me faktin se programi i studimit është i ri dhe se kjo përbën një fushë që ka nevojë për përmirësim në të ardhmen. Gjithashtu mungesa e titujve dhe botimeve fizike shpjegohej edhe me faktin e përdorimit në shkallë të gjerë të platformës elektronike LMS.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DVV konstatohet se Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: Questia, Social Science Library, Sage. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). Nga vizita në Institucion, pavarësisht se u krye në një kohë kur procesi mësimor ka përfunduar u konstatua gatishmëria e stafit të bibliotekës.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga vizita në Institucion përfaqësues të këtij të fundit theksuan për GVJ se sallat e UET janë të pajisura me PC dhe projektorë të cilat shfrytëzohen nga studentët për realizimin e diplomave apo detyrave të kursit. Ata u shprehën se studenti mund të punojë lirisht në Bibliotekë ose në sallën e internetit për detyrat e kursit apo punimin e diplomës që duhet të shkruajë. Orët laboratorike nuk parashikohen specifikisht në këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në mbështetje të dokumentit të DVV, <i>Të dhëna për platformën LMS (Ref. Nr. 46.1, 46.2 dhe 46.3)</i> GVJ konstatoi se në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS. Nëpërmjet këtij sistemi pedagogu bën njoftime, ngarkon syllabusin, prezantimet, leksionet, weblink-e me material shtesë, hedh pikët e çdo vlerësimi për studentët e tij, etj.</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion dhe në mbështetje të dokumentit të DVV, <i>Të dhëna për platformën LMS (Ref. Nr. 46.1, 46.2 dhe 46.3)</i> GVJ konstatoi se në funksion të mësimdhënies, personeli akademik i UET përdor platformën online UET LMS dhe mbështetet në këtë system në një masë të gjerë për të komunikuar në mënyrë të rregullt dhe me procedurë për të gjitha hallkat dhe detajet e procesit mësimor. Nëpërmjet këtij sistemi studenti ka akses gjatë gjithë semestrit në materialet elektronike të lëndëve të programit mësimor. Për studentët që</p>

	regjistrohen në provime ripërsëritëse, GVJ u njoftua se sistemi hapet në sezonin e vjeshtës.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Bazuar në dokumentin B.II, pjesë e Broshurës së dokumenteve. <i>Mbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10)</i> si edhe nga diskutimet e kryera me personelin akademik gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se procesi i temave të diplomave që nga aplikimi deri tek dorëzimi i punimit dhe mbrojtja e temës, është i rregulluar në mënyrë të detajuar. Sipas informacionit të marrë u konstatua sa më poshtë: Pedagogët udhëheqës zhvillojnë seancat metodologjike për të asistuar dhe mbështetur studentët gjatë fazës së shkrimit të temës, sipas një kalendari takimesh, të shpallur. Për studentët që nuk zhvillojnë temë diplomë por i nënshtrohen një provimi përfundimtar formimi këto seanca metodologjike konsistojnë në trajtimin e rasteve studimore të ngjashme me ato që do të jenë pjesë e provimit përfundimtar.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit parashikon qysh në semestrin e parë të studimeve 10 orë në auditor për këto seanca metodologjike. Në semestrin e dytë janë parashikuar 14 orë në auditor. Pra, GVJ konstaton se gjatë gjithë vitit akademik, studentëve nuk u mungon orientimi nga ana e personelit akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Nga shqyrtimi i DVV, <i>Statuti i UET, Neni 16 (Ref. Nr. 2)</i> , GVJ konstaton ngritjen e një strukture për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm. Sipas Statutit, UET ka ngritur Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, KSBC, (më poshtë citat nga Statuti i UET), një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit që vlerëson periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e

	sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit në fuqi.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	GVJ, referuar Broshurës së Dokumenteve, <i>Dokumenti F.V. Për organizimin dhe funksionimin e departamentit (Ref. Nr. 6)</i> , mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit, konstaton se ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron, që nga përzgjedhja e personelit akademik që angazhohet në mësimdhënie e deri tek shpërndarja optimale e ngarkesës mësimore. Nga vizita në Institucion, GVJ-së iu konfirmua se është Përgjegjësi i Departamentit ai që miraton syllabuset e hartuara dhe bën vlerësimin e mësimdhënies. Staf i departamentit dhe studentët janë në dijeni qysh në fillim të vitit akademik që do i nënshtrohen një procesi të vlerësimit të procesit mësimor.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Nga konstatimet që GVJ nxjerr nga dokumentacioni i DVV: <i>Formati për hartimin e syllabusit (Ref. Nr. 19.1)</i> edhe nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në Institucion, bëhet e qartë se drejtuesit e UET kanë një frymë inovatore dhe janë pro me zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përsa kohë që këto metoda i shërbejnë përmbushjes së objektivave të të mësuarit.
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ u bë me dije se personeli akademik nxitet dhe mbështetet të publikojë në revista shkencore, të marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në projekte dhe trajnime që lidhen me fushën e tyre të kualifikimit. Kjo nxitje historikisht ka marrë trajta të ndryshme, si p.sh., akordimi i granteve kërkimore (para vitit 2018), dhe pas këtij viti, stimuj financiarë nëse botimet bëhen në revista me faktor impakti (Scopus). Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentit <i>Formati për hartimin e syllabusit, seksioni i literaturës së rekomanduar (Ref. Nr. 19.1)</i> GVJ konstatoi se gjatë hartimit të syllabuseve, tek literatura e rekomanduar, një nga zërat që kërkohet të evidentohen nga pedagogët është edhe botimet e pedagogut të lëndës në fushën përkatëse; pra bëhet një lidhje e drejtpërdrejtë e fushës së mësimdhënies me ekspertizën kërkimore përkatëse të pedagogut të lëndës.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin	Nga shqyrtimi i DVV (<i>Të dhëna për shkëmbimin e stafit – Ref. Nr. 43.3</i>) si edhe nga bisedat me përfaqesues të

<p>akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>institutionit gjatë vizitës, GVJ konstatoi se vazhdimisht kryhen trajnime të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies si përmes periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1 ashtu edhe për implementimin e metodave të reja përmes trajnimeve nga lektorë të ftuar apo anëtarë të personelit të UET (p.sh., nga zyra e IT, apo njësi të tjera).</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Nga informacionet e marra gjatë diskutimeve me personelin akademik të programit mësimor në vizitën në Institucion, GVJ formoi bindjen se personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik shfrytëzojnë maksimalisht mundësitë e ofruara nga Institucioni për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja të mësimdhënies. Jeta akademike në Institucion paraqitet e pasur me evente si mbledhje, prezantime, forume, etj, të cilat iu bënë me dije GVJ nga prezantimet e përfaqësuesve të Institucionit.</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Sipas dokumentit <i>41 G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik</i>, personeli akademik i UET raporton në baza periodike për aktivitetin e kryer. Sipas diskutimeve me anëtarë të personelit akademik gjatë vizitës në Institucion, në UET personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik nxiten të testojnë metoda të reja në mësimdhënie dhe të analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për to. Çdo vit, gjatë rishikimit të syllabuseve ekziston mundësia për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies dhe kjo u konfirmua nga vetë pedagogët e lëndëve para GVJ.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin pjesë e DVV, por edhe nga bisedat e kryera me personelin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se Institucioni e konsideron prioritet që në rastin e programeve Master Profesional të angazhojë sa më shumë lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve të fushës. Në këtë kontekst në UET janë zhvilluar 11 seanca me lektorë të ftuar, cka është vlerësuar maksimalisht nga studentët e programit të cilët kanë kërkuar shtim të mëtejshëm të këtij elementi në programin mësimor.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Bazuar në shqyrtimin e DVV <i>Rregullorja e programit të studimit (Ref. Nr. 7)</i>; <i>Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1)</i>, GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregulloren e programit të studimit, pika 5 “Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve”, si edhe me dokument të veçantë si pjesë e Broshurës së Dokumenteve. Gjatë vizitës në Institucion, GVJ-së iu bë me dije se këto dokumentacione janë publike për personelin akademik kurse studentëve u njoftohen kriteret dhe mënyra e testimit të njohurive gjatë javës së orientimit (për studentët e rinj), dhe nga pedagogët në auditor kur bëhet prezantimi i syllabuseve për lëndët përkatëse.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Bazuar në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion dhe kryesisht nga diskutimet me studentët e programit të studimit, GVJ konstatoi se ata njihen në fillim të çdo semestri me syllabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Ky prezantim bëhet nga pedagogët zakonisht në orën e parë të çdo lëne. Gjithashtu njoftime të detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen të përditësuara edhe në platformën LMS hap pas hapi gjatë vitit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Referuar <i>Dokumentit për sistemin e vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1)</i> si edhe dosjes së syllabuseve të lëndëve të ofruara në MP në Audit, GVJ konsaton se vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit duke kombinuar testime të ndërmjetme, detyra kursi, ese, projekte, etj. GVJ gjykon se përfshirja e një larmie të formave të vlerësimit u jep mundësinë të gjithë studentëve të shprehin format e vecanta të aftësive dhe talenteve të tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Bazuar në <i>Rregulloren e programit të studimit, pika 5.2 (Ref. Nr. 7)</i> , por edhe në dosjen e syllabuseve, GVJ konstaton se vlerësimi përfundimtar në lëndët e programit të studimit MP në Audit është një rezultante e kombinuar e disa formave të vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit si: <ul style="list-style-type: none"> - Provimi i ndërmjetëm; - Niveli i diskutimit në seminare; - Detyra e kursit / ese; - Provimi përfundimtar;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga shqyrtimi i DVV, GVJ vihet në dijeni se Institucioni ka një bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation) sipas së cilës po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: “clean scoring”. Ky sistem është aplikuar në lëndë të ndryshme si në nivelin bachelor dhe master, <i>por jo në programin e studimit MP në Audit</i> (sipas konstatimeve në bisedën me koordinatoren e programit të studimit gjatë vizitës së kryer nga GVJ në Institucion).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Sipas Rregullores së programit të studimit MP në Audit, <i>Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8 (Ref. Nr. 7)</i> , GVJ konstaton se vlerësimi me komision është i detyrueshëm vetëm për detyrimet si praktika profesionale dhe punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar. <i>Në rastin e lëndëve të programit, është në gjykimin e titullarit nëse korigjimin do e bëjë i vetëm, apo në bashkëpunim me pedagogët asistentë. Vetëm në rastin e ankimimeve, Përgjegjësi i Departamentit ngre një komision me 3 anëtarë, i cili bën shqyrtimin e kërkesës dhe merr vendim me shumicë të thjeshtë.</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim,	Bazuar në shqyrtimin e të dhënave në përmbajtje të DVV (<i>Rregullorja e programit të studimit, pika 5.3 (Ref. Nr. 7)</i>);

<p>zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p><i>Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika E.I.8.6 (Ref. Nr. 9),</i> si edhe në konfirmimet e marra nga personeli akademik gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen të monitoruara nga dy pedagogë dhe me procedurë sekretimi (me barkode unike të gjeneruara për cdo provim), duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore.</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programit të Studimit MP në Audit si edhe mbështetur në informacionet e dhëna nga personeli akademik gjatë vizitës në Institucion, bëhet një korrigjim i kujdesshëm i provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare si edhe i detyrave të kursit të studentëve. Sipas edhe informacioneve marrë nga bisedat e bëra me studentët e programit gjatë vizitës, nëse studenti ka ankesë për ndonjë prej elementëve të vlerësimit në funksion të sqarimit të studentit janë seancat sqaruese ku ata mund të shohin në detaje korrigjimin e pedagogut dhe nga ana e këtij të fundit ofrohen këshilla në funksion të përmirësimit të studentëve në të ardhmen.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Sipas <i>Dokumentit mbi sistemin e vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.6. (Ref. Nr. 7.1)</i> janë përcaktuar rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve. Nga bisedat me personelin akademik, GVJ u informua gjithashtu se gjatë provimit, salla monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë dhe kopjet nuk tolerohen. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet hyrja në ambientet provimit e personave që nuk kanë lidhje me provimin. Sipas <i>Rregullores së UET, Neni 33, (Ref. Nr. 5)</i>, plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga <i>Rregullorja e UET, neni 27 (Ref. Nr. 5)</i> dhe nga bisedat me personelin akademik të programit të studimit, GVJ u informua se vlerësimi për komponentët e vlerësimit gjatë vitit duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe më pas ato nuk ndryshojnë cka konfirmon mbështetje në sistemin e meritës. Bazuar në të njëjtat evidenca, GVJ u informua se si rregull nxjerrja e rezultateve duhet të bëhet dy javë nga data e zhvillimit të tyre, kurse në rastin e riprovimeve, afati për dorëzimin e korrigjimeve është 1 (një) javë (meqënëse ka edhe më pak studentë).</p>

<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Nga <i>Rregullorja e UET, (Ref. Nr. 5), Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8 (Ref. Nr. 7)</i> si edhe nga bisedat me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimit, GVJ konstatoi se studenti informohet për rezultatin përmes sistemit online, UMS, i aksesueshëm vetëm në ambientet e UET. Ai informohet nga kordinatorja e departamentit për orarin që pedagogu ka vendosur për zhvillimin e seancës sqaruese dhe gjtë së cilës studenti ka mundësi të shohë tezën dhe të kuptojë ku ka gabuar.</p>			
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Nga <i>Rregullorja e programit të studimit, pika 5.8 (Ref. Nr. 7)</i> si edhe nga bisedat me personelin akademik dhe studentët e këtij programi studimit, GVJ u informua se nëse studenti ende mendon se vlerësimi nga ana e pedagogut nuk është korrekt, atëherë mund t'i drejtohet Departamentit me kërkesë për rivlerësim. Vlerësimi i Komisionit me tre anëtarë që ngrihet nga përgjegjësi i departamentit është përfundimtar.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit të DVV si edhe përshtypjeve dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ formoi opinionin se programi i studimit Master Profesional në Audit zhvillohet në mënyrë të tillë që u mundëson studentëve të thellojnë njohuritë e tyre dhe të zhvillojnë aftësi profesionale në këtë fushë të vecantë studimi me synim përgatitjen e profesionistëve të auditimit që kërkohen në tregun e punës në Shqipëri.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dosjeve të syllabuseve (<i>Ref. I-16</i>) të Masterit Profesional në Audit, GVJ konstatoi se ka disa tema të cilat trajtojnë elemente të sistemeve të informatizuara, në përshtatje kjo me zhvillimet e këtij profesioni vitet e fundit (auditimi i sistemeve të IT). <i>Megjithatë këto tema janë në një lëndë me zgjedhje që ofrohet</i></p>

<p>huaj).</p>	<p><i>vetëm në njërin prej profileve (Lënda Kontrolli i Brendshëm dhe Audit në profilin Auditim dhe Menaxhim Risku). Përsa i përket vlerave, etikës dhe qëndrimeve në profesion (kërkesa këto edhe të standardeve IES në profesionin e rregulluar të audituesit) më shumë duhet të bëhet që këto elemente të përfshihen në programi e studimit.</i></p> <p>Mangësia e këtyre elementeve u pranua edhe në bisedat e kryera me përfaqësues të Institucionit gjatë vizitës së kryer.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Bazuar në përmbajtjen e dosjeve të syllabuseve (Ref. 1-16) të Masterit Profesional në Audit, GVJ konstatoi se ato përmbajnë dy elemente të shqyrtimit të kompetencave dhe aftësive që fiton studenti në përfundim të programit të studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Eseja, apo detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës; 2. Provimi përfundimtar i çdo lënde;
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Bazuar në <i>Rregulloren e Programit MP në Audit (Ref. Nr. 7)</i>, si edhe në informacionet e marra nga pedagogët e angazhuar në këtë program studimi gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se si rregull në orën e fundit të mësimit, pedagogu mbulon edhe njëherë çështjet më të rëndësishme dhe jep orientimet se ku duhet të fokusohen studentët për përgatitjen e tyre në provim. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në <i>dokumentacionin e DVV</i>, si edhe në informacionet e marra nga përfaqësues të Intitucionit gjatë vizitës, GVJ konstatoi se UET organizon cdo jave seminare, prezantime dhe leksione të hapura për tematika të ndryshme, ku nuk mungonin mbulimi i çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimet teknologjike dhe shkencore.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mbështetur në dosjen e syllabuseve të lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr.1-16) si edhe nga informacionet marrë gjatë vizitës në Insticion, GVJ konstaton se ky program studimi nuk parashikon shfrytëzimin e orëve në laborator (kjo edhe sipas planit mësimor të programit, (Ref. Nr. 14). Kurse praktika profesionale është një detyrim akademik që duke u kryer në pozicione pune sa më pranë fushës së studimit të programit, u jep mundësinë studentëve të zhvillojnë njohuritë teorike të marra në auditor.</p>

<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit MP në Audit, GVJ konstatoi se ata janë të hapur dhe mbështetës për dinamikën e punës në grup sidomos në këtë program specifik. Sipas tyre, kombinimi i studentëve në grupe pune për detyrat dhe projektet e kursit pasuron diskutimet dhe këndvështrimet në ekip dhe mundëson zgjidhjen e problematikave në mënyra inovatore dhe të integruara.</p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Nga diskutimet me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit MP në Audit, GVJ konstatoi se ata operojnë në një ambient të hapur për implementimin e ideve inovatore dhe u kërkohet të inkurajojnë edhe përfshirjen e studentëve, sidomos atyre të ciklit të tretë, dhe të ciklit të dytë Master i Shkencave, në punën kërkimore shkencore. Por programi mësimor është Master Profesional cka limiton, por nuk ndalon plotësisht përfshirjen e studentëve në projektet kërkimore shkencore.</p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në dokumentin <i>Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2020 (Ref. Nr. 3.1)</i>, GVJ informohet se kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies. Por nuk ka evidencë që institucioni ka mbështetur financiarisht studime kërkimore dhe shkencore të studentëve të Programit të Studimit MP në Audit.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ bëhet me dije se tashmë UET si institucion është pjesë e projekteve Erasmus + KA1, çka mundëson rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira. Specifikisht edhe programi i studimit MP në Audit është pjesë e një projekti konkret që pritet të shtojë mundësitë e mobilitetit të studentëve në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.


Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Ëeb site: www.asc.al


E-mail: info@asc.al



<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në DVV (<i>Ref 32 dhe Ref 32.1 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale</i>) Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës, që është njësia përgjegjëse që e ofron këtë program studimi përmes bashkëpunimit me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, garanton mundësitë e nevojshme për realizimin e praktikës profesionale pranë institucioneve pritëse.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në DVV (<i>Ref 32 dhe Ref 32.1 Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale</i>), dhe bazuar edhe në prezantimet e kryera nga stafi pedagogjik gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstatoi se studentet e masterit profesional në Audit mund të kryejnë stazhe profesionale në institucione të ndryshme me të cilat UET ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këto institucione ata kanë mundësinë të njihen me format dhe teknologjitë më të fundit dhe bashkëkohore, pasi janë institucione të rëndësishme në vend.</p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Referuar <i>Planit Mësimor të MP në Audit (Ref. Nr. 14)</i>, praktika profesionale ka 6 kredite në programin e studimit. Sipas dokumentit <i>Mbi praktikën profesionale (Ref. nr. 32.2)</i>, dhe nga informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua se për mbikëqyrjen e praktikave profesionale Departamenti cakton një pedagog përgjegjës. Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, pedagogu që e mbikëqyr studentin gjatë praktikës ka për detyrë të dorëzojë pranë Koordinatorës së Departamentit formularin e vlerësimit të studentit, formularin e vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në kompani, formularin e vetëvlerësimit të plotësuar nga studenti dhe raportin përfundimtar të praktikës të përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës. Më pas vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet përpara një komisioni.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e

studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar Dokumentit B.II “Për punimin e diplomës” (Ref. Nr. 10), GVJ konstaton se janë paraqitur në mënyrë të detajuar procedurat që ndiqen për aplikimin për temë diplome e më pas për miratimin e saj (nëse studentët kanë mesatare në hyrje më të lartë se 7.5), procesin e udhëheqjes përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. Nga bisedat e zhvilluara me studentët e programit të studimit GVJ konstaton se ky informacion i vihet në dispozicion edhe studentit përpara aplikimit për punim diplome.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Referuar Dokumentit B.II “Për punimin e diplomës” (Ref. Nr. 10), GVJ konstaton se studentët e programit MP në Audit në përfundim të studimeve të tyre aplikojnë për temën e punimit të diplomës në grupe me 3-5 studentë sipas dëshirës dhe zgjedhjes së lirë të tyre. Të drejtën për të aplikuar për punim diplome e kanë studentët me notë mesatare në hyrje së paku 7.5. Personeli akademik asiston studentët në procesin e diplomimit përmes seancave metodologjike. Për studentët që përgatisin punim diplome, pedagogu udhëheqës i udhëzon për strukturën e projektit, metodologjinë, i orienton studentët drejt literaturës që ata duhet të lexojnë në funksion të projektit, u jep udhëzime dhe të gjitha materialet e nevojshme për përfundimin me sukses të projektit. Studentët që i nënshtrohen provimit të përgjithshëm orientohen në lidhje me literaturën që duhet të shfletojnë, si edhe u zhvillohen në klasë raste studimore të ngjashme, me qëllim që të familjarizohen me këtë formë testimi <i>B.IIMbi punimin e diplomës (Ref. Nr. 10)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Mbështetur në <i>Dokumentin për sistemin e vlerësimit të studentëve, pika A.IV.2.3, AIV.2.5. e-g. (Ref. Nr. 7.1)</i> , dhe në informacionet e marra gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se për programin MP në Audit, provimi i përgjithshëm i formimit është konceptuar si një rast studimor kompleks, i lidhur me profilin studimor të studentit, duke qënë se edhe fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të	Referuar Dokumentit B.II “Për punimin e diplomës” (Ref. Nr. 10), dhe nga informacionet e marra nga personeli akademik dhe studentët e programit, GVJ konstaton se

studimit/diplomave.	pedagogu udhëheqës e orienton dhe e ndihmon studentin jo vetëm në fillim për përcaktimin e temës së diplomës, por edhe gjatë punës dhe zhvillimit të temave duke zhvilluar seanca metodologjike orientuese me grupin e studentëve që ai udhëheq.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Referuar Dokumentit B.II.5.2 <i>“Për punimin e diplomës”</i> (Ref. Nr. 10), dhe nga informacionet e marra nga përfaqësues të Institucionit dhe studentët e programit, GVJ konstaton se UET është i angazhuar që kurdoherë të ofrojë ndihmën e tij për të lehtësuar procesin e diplomimit të studentëve duke garantuar seancat oreintuese dhe këshilluese nga ana e personelit akademik udhëheqës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Referuar Dokumentit B.II.5.2 <i>“Për punimin e diplomës”</i> (Ref. Nr. 10), dhe nga informacionet e marra nga personeli akademik dhe studentët e programit, GVJ konstaton se pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike prek çështje të tilla si: trajtimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj); punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj. I njëjti dokument specifikon gjithashtu se udhëheqësi është garantues i cilësisë së punimit të diplomës të studentit. Diploma nuk mund të dorëzohet për mbrojtje nga studenti, pa marrë firmën e pedagogut udhëheqës. <i>Dokumenti për punimin e diplomës, pika B.II.8.8 (Ref. Nr. 10).</i>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Referuar Dokumentit B.II.5.2 <i>“Për punimin e diplomës”</i> (Ref. Nr. 10), GVJ informohet se provimi përfundimtar i formimit dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të studentëve.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Referuar Dokumentit B.II.5.2 <i>“Për punimin e diplomës”</i> (Ref. Nr. 10), GVJ konstatoi se në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Format i diplomës dhe i suplementit gjenden si pjesë e DVV të shqyrtur nga GVJ. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të Institucionit, GVJ konfirmoi këto procedura.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në	Në përputhje me Dokumentin B.II.5.2 <i>“Për punimin e diplomës”</i> (Ref. Nr. 10), GVJ informohet se studentit ka të

dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar. Gjatë vizitës, GVJ nuk pati mundësi të konfirmonte këtë praktikë, pasi nuk e shtroi si kërkesë apo pyetje për Institucionin, por kjo nuk cënon besueshmërinë dhe materialitetin e gjithë procesit të diplomimit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Referuar Dokumentit B.II.5.2 “Për punimin e diplomës” (Ref. Nr. 10), GVJ informohet se pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Gjatë vizitës në Institucion, GV pati mundësinë që të kërkonte informacione për studentët pranë sekretarisë mësimore dhe konfirmon përbushjen e kërkesave për informacion të paraqitura nga ana e tyre.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në organikën e tij ka ngritur zyrën e Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Veprimtaria e zyrës mbështetet në Rregulloren e Burimeve Njerëzore (Ref. Nr. 11). Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës të angazhuar në organizimin e programeve të studimit që ofron ky institucion.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në përputhje me bazën ligjore në fuqi, neni nr. 44 i Statutit të UET dhe Rregullorja e Burimeve Njerëzore përcaktojnë procedurat e rekrutimit të personelit akademik. Përgjegjësi i Departamentit përcakton kriteret e punësimit të cilat miratohen nga Rektori (sipas Statutit), dhe bën planifikimin e stafit akademik i cili sipas rregullores miratohet nga Dekani. Më pas bëhet shpallja e vendeve vakante dhe kriterëve përkatëse në media dhe në faqen e internetit të institucionit. Aplikimet i drejtohen Zyrës së Burimeve njerëzore, e cila pasi bën përzgjedhjen e kandidatëve në varësi të plotësisimit të kriterëve, përgatit listën e kandidatëve që do të paraqiten për intervistë. Rektori ngre komisionin e rekrutimit, i cili sipas rregullores së rekrutimit përbëhet nga përfaqësues të rektoratit, dekanatit të Fakultetit Ekonomik dhe përgjegjësi i Departamentit të Financës si dhe ekspertë të fushës. Miratimi i tyre bëhet në fund të muajit shtator dhe në muajin tetor lidhet kontrata e punës.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me procedurat që ndiqte kjo zyrë që nga thirrja që shpallej për vende të lira pune për pedagogë deri në nënshkrimin e kontratës së punës. Në</p>

	mënyrë rastësore GVJ shqyrtoi dosjen e dy pedagogëve të këtij programi studimi të cilat përmbanin të gjithë elementët e nevojshëm të përcaktuar në “Listën e elementëve që përmban dosja e stafit akademik” (Ref. Nr. 44 dhe 44.1). GVJ konstatoi se dosjet ishin të plota.			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Rregullorja e Burimeve Njerëzore (Ref. Nr. 11), e hartuar në përputhje me statutin e UET përcakton procedura dhe kritere të posaçme për rekrutimin e personelit, të cilat bëhen publike nëpërmjet medias dhe faqes së internetit të institucionit.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik përcaktohen në Rregulloren e Burimeve Njerëzore. Departamenti pas një analize të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave konstaton nevojën për personel të ri akademik, i paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në Dekanat. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, argumentimin e këtij propozimi, si dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm, sipas vendeve vakante në departament. Në këtë mënyrë përzgjedhja e personelit bëhet në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë	Institucioni angazhohet që ti sigurojë personelit akademik dhe personelit ndihmës kushte dhe mjedise pune të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë profesionale. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor (salla leksioni, seminari, laboratorë etj) dhe zyra të përshtatshme për

profesionale.	kryerjen e detyrave të ndryshme administrative.			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion, si nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e programit të studimit, edhe nga takimi me pedagogë të këtij programi studimi, GVJ iu konfirmua angazhimi nga institucioni për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon programin e studimit MP “Audit”. Vazhdimisht pedagogët kanë marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, kanë botuar atikuj në revista shkencore (Ekonomikus është një revistë e UET që boton artikuj në fushëm ekonomike), si dhe janë përfshirë në projekte të financuar nga donatorë të ndryshëm.</p> <p>Sipas RVB, por edhe nga konfirmimi i vetë pedagogëve gjatë takimit me ata, UET ka krijuar një fond prej 75.000 Euro për stafin që boton artikuj në revista shkencore të indeksuara në Thomson Reuters, si dhe së fundmi një Grup Kërkimi Ndërdisciplinor prej 10 profesorësh të disiplinave të ndryshme, të cilëve iu është akorduar një fond vjetor për kërkim shkencor, prej 5.000 euro/secili.</p>			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe të teknologjive të reja për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe kualifikimin shkencor të personelit akademik.</p> <p>Meqënëse program i studimit MP në “Audit” është hapur në kuadër të projektit FINAC, vizitat e kryera në institucionet e arsimit të lartë në kuadër të këtij projekti, kanë shërbyer për shkembimin e përvojave dhe kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik.</p>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Angazhimi i burimeve njerëzore nga institucioni, duke marrë parasysh si kualifikimin shkencor të tij (të gjithë pedagogët e angazhuar në këtë program studimi kanë tituj/grada apo kualifikim të lartë në fushën e auditit) edhe ngarkesën mësimore, bëhet në drejtim të përmbushjes së objektivave të programit të studimit MP “Audit”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Institucioni siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse. Sipas RVB, veprimtaria e mësimdhënies zhvillohet në 10 salla leksioni me sipërfaqe totale 1510m ² dhe 1515 vende, 14 salla seminari, me sipërfaqe 45m ² dhe secila me nga 35 karrige, dhe 9 salla 70 vendëshe (leksione + seminare) me sipërfaqe 100m ² secila.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset të tjera dhe vuri re që mjediset mësimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe foni. Gjithashtu nëpërmjet përdorimit të sistemeve LMS dhe UMS, studentët kanë mundësi të marrin informacionin e nevojshëm si në lidhje me materialet mësimore që vihen në dispozicion nga pedagogët, edhe në lidhje me vlerësimin e tyre nga pedagogët.
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Sallat ku zhvillohet mësimi i programit të studimit MP në “Audit” janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe foni. Sipas informacionit të marrë nga vizita në institucion, në PC në laboratorë janë instaluar edhe programet e kontabilitetit (si Financa 5) që u jep mundësi studentëve që të punojnë për detyra dhe projektet e tyre të kursit.
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	Institucioni ka katër laboratorë informatike, të pajisur me programe profesionale. Një prej tyre ka të instaluar edhe programet e kontabilitetit në përputhje me natyrën e programit të studimit MP në “Audit”. Nga vizita në institucion, na u konfirmua që studentët e këtij programi mund të përdorin këto laboratorë për punimin e detyrave/projekteve të kursit, pasi në planin mësimor të këtij programi studimi nuk janë parashikuar

	orë laboratorike.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon për kryerjen e praktikave profesionale (Ref. Nr 32 dhe 32.1)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas RVB, biblioteka e institucionit ndodhet në godinën C të Kampusit të UET, dhe ka një sipërfaqe prej 300m ² . Studentët e MP në “Audit” kanë mundësi për përdorimin e bibliotekës si edhe të gjithë studentët e tjerë të universitetit.
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Gjatë vizitës në ambjentet e bibliotekës, GVJ konstatoi se biblioteka ishte e pasur me tituj librash dhe revistash shkencore në fusha të disiplinave të ndryshme të ofruara nga UET. Ndër to kishte edhe literaturë në fushën e financës dhe kontabilitetit. <i>Por GVJ vuri re se literatura fizike që i përket veçanërisht programit të studimit MP në “Audit” pothuajse mungonte. Sikurse u shpreh edhe përgjegjësi i departamentit, plotësimi i bibliotekës me tituj në fushën e auditimit është një ndër përmirësimet që do bëhet në vitin akademik në vijim.</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e këtij programi na u konfirmua se ata kanë mundësi të përdorin si literaturën fizike të disponueshme në bibliotekë, si edhe të aksesojnë në bibliotekën online si Sage, Ebsco dhe Questia të ofruar nga institucioni (sipas RVB).</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë nga GVJ u konstatua se biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe internet në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga institucioni. Nga RVB dhe gjatë vizitës në bibliotekë, GVJ u informua se biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS.NET, i cili është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së bibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të të dhënave dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse. Në këtë mënyrë biblioteka e UET bashkëpunon edhe me bibliotekat e tjera në vend për të shkëmbyer titujt e librave për të cilat ka kërkesa nga studentët.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur (<i>Ref. Nr. 45.1: Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë; Ref. Nr. 45.2: Shembull procedurë blerje literature</i>), dhe nga takimi me pedagogë, GVJ konstatoi se institucioni ndjek një procedurë të detajuar për përmirësimin dhe shtimin e literaturës në bibliotekë.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Sipas RVB biblioteka është e hapur në orare duke iu përshtatur edhe orareve të zhvillimit të procesit mësimor: nga e hënëpremtë 9:00-20:00 dhe ditën e shtunë 9:00:17:00,. gjatë sezonit të provimeve është e hapur me orar të zgjatur.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të UET (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, të dhënave akademike, realizimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. lidhur me studentët. UMIS përmban informacionin personal të studentit që nga regjistrimi i tyre, vlerësimin me nota dhe deri në diplomimin e tyre.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të UET (UMIS) administron edhe informacionin lidhur me lëndët që jep personeli akademik për çdo semestër dhe është i aksesueshëm nga sekretaria dhe studentët. Ndërsa komunikimi i personelit akademik me studentët lidhur me materialet mësimore dhe vlerësimin e studentëve bëhet nëpërmjet platformës LMS të UET.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Platforma UET LMS është azhurnuar me të gjithë informacionin bazë si: regjistrimi i të gjithë studentëve në lëndët e tyre përkatëse të cilët kanë akses të plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin por jo në materialet e lëndëve që nuk i përkasin; regjistrimi i të gjithë pedagogëve përgjegjës për çdo lëndë, ku secili pedagog mund të shohë vetëm lëndët e veta dhe të menaxhojë lehtësisht të gjithë literaturën e lëndëve përkatëse. Sipas RVB dhe siç e konfirmuan edhe pedagogët gjatë takimit me GVJ, sistemi ofron mundësi që pedagogët të komunikojnë me studentët për çdo çështje lidhur me aktivitetin mësimor: që nga hedhja e materialeve mësimore, ushtrimeve, detyrave të kursit, vlerësimin të studentit etj.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit	Platforma UET LMS është një platformë me <u>bazë-webi</u> i të mësuarit që u lejon studentëve aksesimin e materialeve për kurset ku janë regjistruar. Nëpërmjet kësaj platforme pedagogët dhe studentët kanë mundësi të komunikojnë si individualisht edhe në grup, ku përveç komunikimit dhe

ndërmjet personelit dhe studentëve.	shkëmbimit të materialeve mësimore mund të përfshihen edhe në diskutime onhline në grup. Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu demonstrua kjo platformë komunikimi gjatë takimit me grupin e pedagogëve.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Platformat UMIS dhe LMS mundësojnë që drejtuesit dhe titullarët e institucionit të monitorojnë në kohë reale aktivitetin akademik dhe administrativ nëpërmjet raporteve statistikore që sigurohen nga sistemi në fund të çdo semestri.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>Faqja zyrtare e institucionit (www.uet.edu.al) përmban informacion kryesor në lidhje me Universitetin: filozofinë dhe misionin, fakultetet dhe degët që ofrohen në bachelor dhe master, drejtimin dhe funksionimin, organigramën, projektet dhe bashkëpunimet, kërkimin shkencor, rrjetin alumni, botimet e UET-Press-it si dhe shërbime të tjera që ofrohen nga UET-i. Në këtë faqe pasqyrohen me foto dhe me tekst aktivitete të ndryshme që ndodhin pranë UET-it, si konferenca të ndryshme, seminare, leksione të hapura, takime me personalitete të rëndësishme vendase ose të huaja.</p> <p>Sipas RVB faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi guidat për studentët e ardhshëm të Universitetit si dhe mbi programet dhe syllabuset e lëndëve.</p> <p>Në fakt, nga një shqyrtim i faqes zyrtare online të UET, lidhur me programin e studimit MP në Audit, informacioni që paraqitet nuk është shumë i saktë: si për sa i përket emërtimit të programit, si edhe ndonje profili që nuk është i saktë. Aktualisht UET e ka faqen e internetit vetëm në gjuhën shqipe, por sipas RVB në të ardhmen parashikohet që të jetë edhe në gjuhën angleze.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	
Standardi IV.6				
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			

<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Sipas RVB buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm i shoqërisë. Për zbatim të këtij buxhetime, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Gjithsesi GVJ nuk i është vënë në dispozicion ndonjë dokument i tillë.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekë dhe pasurimin e literaturës e aksesit në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Raporti financiar nuk është vënë në dispozicion të GVJ. Në dispozicion të GVJ janë vënë dy dokumente. “Të dhëna për kosto për student” (Ref. Nr. 49) i cili paraqet koston mesatare për student për tre vitet e fundit akademike, por nuk përmban në mënyrë të detajuar llojin e shpenzimeve që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e koston; dhe “Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në gjashtë vitet e fundit” (Ref. Nr. 50), në të cilin jepen tre burimet kryesore të sigurimit të të ardhurave, që për vitin 2018 ishin përkatësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tarifa për dhe gjatë shkollimit 95%; - grante për kërkim dhe nga kontratat 2,7%; - të ardhurat nga aktivitete tregtare 2,3%; <p>Këto janë të dhëna të paraqitura për të gjithë institucionin, në pamundësi për t’i llogaritur veçan për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Sipas RVB Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. EEI shpk përgjatë vitit 2016-2017 ka marrë konsulencë financiare nga shoqëria “Deloitte Albania”. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatit e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Me kërkesë të GVJ, UET vuri në dispozicion raportin e audituesit ligjor për bilancin e vitit 2017, i cili ka audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “European Education Initiative” sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar në datën 31 dhjetor 2017,</p>

	<p>pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë që mbyllet në këtë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit të audituesit ligjor, pasqyrat financiare të shoqërisë “EEI” janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standartet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas RVB UET ka raport auditiv çdo vit. Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë perkatese, shfrytëzimin dhe eficienten e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për studentët.</p> <p>Me kërkesën e tij, GVJ u njoh me raportin e audituesit ligjor për bilancin e vitit 2017, i cili ka audituar pasqyrat financiare të shoqërisë “European Education Initiative” sh.p.k. (e shpjeguar më sipër).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Për sa i përket qëndrueshmërisë financiare të institucionit, me dokumentat e vëna në dispozicion, GVJ nuk mund të japë një opinion të tijin, pasi edhe pasqyra e të ardhurave dhe ajo e shpenzimeve të vëna në dispozicion nga institucioni nuk kanë bazë të njëjtë krahasueshmërie (të dhënat për kosto për student jepen në vite akademike, ndërsa të dhënat mbi burimet e financimit jepen në vite kalendarike). Raporti i audituesit ligjor për vitin 2017, i vënë në dispozicion me kërkesën e GVJ, nuk shprehet lidhur me qëndrueshmërinë financiare të institucionit. Gjithashtu Plani strategjik 2015-2020, pavarësisht se ka njëqështje që emërtohet “Qëndrueshmëria financiare dhe intitucionale” nuk përmban asgjë lidhur me këtë çështje.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	-------------------------------------

				X
--	--	--	--	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Sipas Statutit të UET (neni nr. 31, 32 dhe 33) dhe aktet rregullatore të hartuara në bazë të tij mbi politikën, procesin dhe kriteret e pranimit të studentëve“ (Ref. Nr. 27.1), mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin“ (Ref. Nr. 28), rregullojnë politikën dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi.
Kriteri 2. Politikën dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se politikën dhe procedurat që ndjek UET nga hyrja në dalje e studentëve garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët studentë dhe studentët të programit të studimit.
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, procedurat e pranimit të përzgjedhjes së studentëve, përparimit të tyre, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme, të vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përcaktuar qartë dhe kuptueshëm në aktet rregullatore të nxjerra nga UET, dhe në veçanti në rregulloren e programit mësimor të cikilit të dytë të studimeve MP në“Audit”. Këto procedura janë lehtësisht të aksesueshme online nga publiku.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Në bazë të akteve rregullatore, çdo vit akademik institucioni publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për tu pranuar në ciklin e dytë të studimeve.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni	Bazuar në dokumentin “Politikën e prezantimit dhe promovimit

udhëzohet publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	të UET online”(Ref. Nr. 48) dhe dokumentin “Komunikimi i integruar i marketingut”(Ref. Nr. 51), institucioni njih dhe udhëzohet publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e programit të studimit si nëpërmjet faqes zyrtare online edhe nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale, apo mediave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Rregullorja e programit të studimit të MP në “Audit”, pikat 5 dhe 6, vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Referuar nenit nr. 37 të Statutit të UET dhe pika nr. 9 e Rregullores së programit të studimit të MP në “Audit” informojnë studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Nëpërmjet Rregullores së programit të studimit të MP në “Audit” (pika nr.5) dhe syllabuseve të lëndëve/moduleve që zhvillohen në këtë program studimi, studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	UET informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit, si në faqen zyrtare të tij online, por në mënyrë më të hollësishme nëpërmjet neni nr. 40 të Statutit të UET dhe pikës nr. 8 të Rregullores së programit të studimit të MP në “Audit”.

Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Gjatë vizitës së institucion, GVJ u informua se në fillim të çdo viti të ri akademik, UET zhvillon “Javën e Orientimit”, nëpërmjet të cilës studentët e rinj njihen me programet e studimit, pedagogët, ambjentet dhe disa nga rregullat bazë të universitetit. Gjithashtu edhe faqja zyrtare online dhe rrjetet sociale japin informacion për të interesuarit mbi programet e ardhshme të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit; takimeve me Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit si dhe nëpërmjet Rregullores mësimore të programit të studimit MP në “Audit”.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Informacioni lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre u jepet studentëve në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafik akademik dhe ndihmes. Për të gjithë të interesuarit plani mësimor i MP në “Audit” është i aksesueshëm online në faqen zyrtare online të UET (me disa mospërputhje që u evidentuan më sipër).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni informon si studentët potencialë edhe ata që rregjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofron ky program studimi nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> - zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit; - bordeve të tregut të punës; - dhe lajmerimet dhe njoftimet e studentëve mbi

	mundësitë e ndryshme për punësim; Gjatë takimit me Zyrën e Këshillimit të Karrierës, GVJ u informua që studentët që përfitojnë bursa, kryejnë një numër të caktuar orë pune duke u angazhuar në kryerjen e detyrave të caktuara në institucion.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	I gjithë informacioni lidhur me zhvillimin e procesit mësimor (orari mësimor, plani mësimor, ndryshimet e orarit) u komunikohen studentëve nga koordinatori i programit të studimit nëpërmjet publikimit të informacionit në këndin e njoftimeve dhe/ose online nëpërmjet komunikimit me e-mail dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit LMS.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Informacioni lidhur me programin e studimit dhe zhvillimin e procesit mësimor është lehtësisht i aksesueshëm nga studentët kudo që ata ndodhen, si rezultat i përdorimit të platformës LMS të sistemit të menaxhimit të informacionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi që ofron. Për programin e studimit MP në Audit meqënëse nuk ka përfunduar, disponon statistika për numrin e studentëve në hyrje dhe numrin e të punësuarve. Sipas dokumentit nr. 27 dhe nga vizita e GVJ në sekretarinë mësimore, numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është 42 studentë.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e	Institucioni si rregull disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të

studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Deri tani, nuk ka të larguar apo të transferuar nga programi i studimit MP në "Audit".			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përmbajnë të dhënat e studentëve nga momenti i regjistrimit deri në momentin e largimit/diplomimit të tyre. Dokumenti "Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore"(Ref. Nr. 9) rregullon punën dhe procedurat e sekretarisë mësimore.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të informacionit UMIS, një program informatik i cili administron dhe përpunon të dhënat e studentëve nga sekretaria, drejtuesit dhe personat e autorizuar në kohë reale.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Për çdo program studimi, institucioni harton raporte analitike mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe shkallën e punësimit të tyre. Zyra e këshillimit të karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar nëpërmjet strukturës Alumni UET. Për programin e studimit MP "Audit", meqënëse nuk ka ende të diplomuar, institucioni ka përgatitur dokumente mbi cilësinë në hyrje të studentëve (Ref. Nr. 27) dhe numrin e të punësuarve deri më tani (Ref. Nr. 29). Nota mesatare e studentëve që janë regjistruar në këtë program studimi varion nga 5,19 në 9,7. Numri i studentëve të punësuar në këtë program studimi është 17.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së

burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Sipas neneve 15, 19 dhe 51 të statutit të UET. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Sipas Statutit dhe akteve rregullatore të UET, studentët marrin pjesë në:</p> <ul style="list-style-type: none">• Këshillin e Studentëve• Senatin Akademik• Këshillin e Etikës• Komisionin e sigurimit të brendshëm të cilësisë• Mbledhjet e departamentit përkatës• Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit MP në “Audit”. <p>Përveç pjesëmarrjes në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, studentët marrin pjesë në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet focus-grupeve, plotësimit të formularëve për vlerësimin e lëndëve dhe pedagogëve dhe takimeve që kanë me personelin akademik. Të dhënat e mbledhura analizohen në nivel të njësisë bazë, kryesore dhe institucioni me qëllim përmirësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të institucionit.</p>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Ngarkesa e programit të studimit MP në “Audit” është e shpërndarë në mënyrë uniforme gjatë dy semestrave të zhvillimit të procesit mësimor. Sipas planit mësimor, semestrin e parë, studentët ndjekin pesë lëndët bazë, ndërsa semestrin e dytë ndjekin tre lëndët sipas profilit, kryejnë praktikën mësimore dhe punojnë për provimin përfundimtar. Njohja e studimeve të plota ose të pjesshme të mëparshme rregullohet me rregulloren e programit të studimit.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e	Nëpërmjet përfshirjes së studentëve në focus grupe, mbledhjeve të hapura me departamentitn që realizohen çdo

studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	muaj në prani të studentëve dhe pedagogëve dhe analizës së formularëve të vlerësimit, institucioni garanton marrjen dhe përfshitjen e opinionit dhe sugjerimeve të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Një analizë paraprake e pyetsorëve të plotësuar nga studentët është paraqitur në dokumentin “Raport paraprak i vlerësimit të programit të studimit MP “Audit”(Ref. Nr. 38).			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e programit të studimit MP “Audit” (pika 5 dhe 6) dhe syllabuset e lëndëve që u vihen në dispozicion studentëve që ditën e parë të mësimit në platformën LMS, shpjegojnë mënyrën e vlerësimit të kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës, duke garantuar një proces transparent nga momenti i kryerjes së provimit deri në dhënien e rezultatit përfundimtar. Kjo procedurë u konfirmua edhe nga studentët e pranishëm në takimin me GVJ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit quhet njësi e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në UET. Funkcionet dhe detyrat e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit rregullohen nëpërmjet dokumentit “Mbi funksionimin e mënyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj Studentëve”(Ref. Nr. 12). Këshillimi dhe kujdesi ndaj studentëve ofrohet edhe nëpërmjet tutoriatit dhe këshillimit akademik (Ref. Nr. 27.2).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e kampusit, mësojnë studentët në lidhje me politikat e

<p>studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Universitetit, ndërmjetësojnë mosmarrëveshjet organizative dhe individuale, këshillojnë programe dhe aktivitete të veçanta, mbështesin studentët për qeverinë studentore, menaxhojnë hapësirën ku qëndrojnë studentët e qeverisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e këshillimit të Karrierës e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit. Zyra e karrierës organizohet me persona, të cilët kanë orare të shpallura të pritjes së studentëve. Zyra mban kontaktet e studentëve të interesuar, me të cilët komunikon vazhdimisht duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Detyrat e kësaj zyre janë: Këshillim i vazhdueshëm për studentët, duke i mbështetur në hartimin e CV, Letrës së motivimit & Korrespondencën me zyrat e Burimeve Njerëzore të kompanive/organizatave; letrës së falenderimit, letrës së refuzimit të pozicionit, (trajnime online dhe offline); Këshillim të studentëve për faza të intervistës së punës; Përgatitja e kalendarit të eventeve të lidhura me industrinë – Open Day për çdo fakultet dhe panairët e punës; Zhvillimi i sondazhit të planit të karrierës së studentëve. –raporti të ndihmon të kuptosh punësimin - burimin, intershipet – burimin dhe planet e karrierës së studentëve; Zhvillimi i sondazhit të besnikërisë ndaj UET (Ref. Nr. 12).</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Me diplomimin e brezit të parë të studentëve në UET në vitin 2009, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni (sipas takimit me zyrën e Këshillimit të karrierës, deri tani ka rreth 10.000 studentë të diplomuar, nga të cilët 50% i përkasin fakultetit të Ekonomisë), me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të marrë mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin e programeve të studimit për t’iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë. Për të forcuar edhe më shumë lidhjet me studentët e diplomuar, ata janë përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve dhe kanë krijuar disa forume si <i>Alumini Leadership</i> dhe <i>Alumini</i></p>

	<i>Sipërmarrës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<i>Neni 11 i Statutit të UET përcakton se institucioni harton politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nëpërmjet të cilit realizohet vlerësimi dhe garantimi i cilësisë së ushtrimit të veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të UET.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<i>Institucioni ka të ngritur dhe ka vënë në zbatim Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë (Ref. nr. 32, Ref. Nr. 33). Në strukturat e ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) (Statuti, neni nr. 16 pika 2) përfshihen edhe studentë dhe ekspertë të jashtëm.</i>
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të	<i>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet: (Statuti, neni nr. 11)</i> <ul style="list-style-type: none"> • Strukturave hirearkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave

<p>vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>për realizimin e vizionit të tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> Njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë që vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore të Universitetit. Kjo realizohet nëpërmjet Zyrës së Standardeve dhe Cilësisë dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. <p>Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UET i është nënshkruar vlerësimit periodik institucional (me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike sipas vendimit të BA nr. 12, datë 07.04.2017) dhe të programeve të studimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>UET ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Nëpërmjet akteve rregullatore, ka përcaktuar detyrat dhe funksionet e strukturave të ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (<i>Ref. Nr. 8</i>), që synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë: Strukturat hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet) të UET-it (<i>Ref. Nr. 8</i>):</p> <p>Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, e cila kujdeset për hartimin, përditësimin dhe rishikimin e kuadrit rregullator të institucionit</p>


	<p>dhe procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë dhe praktikat e mira kombëtare dhe ndërkombëtare, si edhe monitoron zbatueshmërinë e tyre nga strukturat dhe personeli i institucionit.</p> <p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë – KSBC, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive që ushtrohen në UET, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p>Këto struktura bashkëpunojnë me Departamentet që janë përgjegjëse për zhvillimin e programeve të ciklit të dytë, për shqyrtimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UET përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë. UET harton një raport vlerësimi periodik mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar (<i>Ref. Nr. 38</i>). Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>UET përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. Aktivitetet e vlerësimit dhe monitorimit të programit të studimit hartohen nga KBSC dhe miratohen nga rektori në formën e planit të veprimit (<i>Ref. Nr. 30.1</i>) dhe për secilin aktivitet vlerësimi/monitorimi përcaktohet njësi përgjegjëse për kryerjen e tij si dhe afati i zbatimit të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Një nga parimet mbi të cilat është ndërtuar Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e UET-it, njërive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. (<i>Ref. Nr. 8</i>). Rezultatet e KSBC-së publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Përgjegjësve të Departamenteve. (<i>Ref. Nr. 8</i>). Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe gjatë vizitave në institucion GVJ konfirmon se rezultatet e vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit (<i>Ref. Nr. 30.7, Ref. Nr. 37</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e</p>	<p>Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit të aktivitetit mësimor dhe</p>

vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	kualifikimit shkencor është përmirësimi i mëtejshëm i mësimdhënies. Rezultatet e nxjerra nga procesi i vlerësimit i shërbejnë drejtuesve për të ndërmarrë aktivitete në kuadër të përmirësimit dhe qëndrueshmërisë së programit të studimit MP në “Audit” (Ref. Nr. 38).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	KSBC në bashkëpunim me departamentet bën vlerësimin e programeve të studimit që ofrohen nga secili department. Rezultatet e marra përfshihen në vetëvlerësimin e brendshëm periodik të institucionit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	UET përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit (Ref. Nr. 30.5, 30.6, 30.8, 40, 40.1, 41). Disa prej metodave që UET përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë monitorimin e elementëve të lidhur me proceset akademike si provime, syllabuset, literatura e përdorur etj.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së	Institucioni i arsimit të lartë, UET, përdor metoda të drejtpërdrejta vlerësimi si: teste të standardizuara; dëgjime në auditor; vlerësime me pikë; testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, vëzhgime në auditor veçarëisht për

<p>mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>pedagogët e rinj etj.</p> <p>Nëpërmjet këtyre metodave, institucioni bën vlerësimin e mësimdhënies, cilësisë së syllabuseve, vlerësimin e provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare etj. Për çdo aktivitet apo metodë hartohet një raport vlerësimi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>UET kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodave të tërthorta, kryesisht në formën e plotësimit të pyetsorëve on-line nga studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët, vetvlerësimit të pedagogëve, sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; pyetje konceptuale; intervista. (Ref. Nr. 40, 40.1, 41). Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, njësisë kryesore dhe njësisë bazë si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë në UET sigurohet nëpërmjet KBSC në përbërje të të cilit është edhe një ekspert i jashtëm, i cili së bashku me organe të tjera këshilluese siç është Bordi</p>



<p>brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>i Tregut të Punës, përfshin edhe bashkëpunëtorë të jashtëm për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Programi i studimit MP në “Audit” ka filluar në kuadrin e projektit “FINAC” që është një bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë në rajon dhe më gjerë. Bashkëpunimi midis këtyre institucioneve, shkëmbimi i përvojave dhe vizitat e ndërsjellta të kryera midis këtyre institucioneve, kanë ndihmuar në përmirësimin e politikave dhe procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas RVB dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se strukturat që shërbejnë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, së bashku me anëtarët e tyre, kanë detyra të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit dhe garantojnë ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Referuar Vendimit mbi Përbërjen e KSBC (<i>Ref. Nr. 30.4</i>), Komisioni i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti (dy nga Fakulteti i Ekonomisë, Zvillimit dhe Biznesit), një përfaqësues nga personeli administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në mënyrë që të respektohet integriteti akademik dhe të shmangët çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie, përzgjedhja e anëtarëve të KSBC bëhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme (<i>Ref. Nr. 8</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> Kompetencat profesionale; Cilësitë personale (si ndershmëria, korrektesa, serioziteti, përgjegjshmëria, etj.); Ngarkesa mësimore apo ngarkesa me kryerjen e funksioneve të tjera administrative; Eksperiencia e mëparshme në detyrë të njëjtë apo të përafërt; Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it.
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe</p>	<p>Për të vlerësuar programet e studimit UET angazhon ekspertë apo bashkëpunëtorë të jashtëm, nëpërmjet përfshirjes së tyre në KSBC dhe nëpërmjet organeve</p>

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	këshilluese si Bordi i Tregut të Punës, që bën takime të paktën dy herë në vit me palët e interesuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit nëpërmjet statutit të UET dhe akteve rregullatore të tij.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e KSBC-së publikohen përmes një raporti të brendshëm që i dërgohet Rektorit dhe Administratorit të UET. Pjesët e raportit që lidhen me Fakultetet përkatëse i vihen në dispozicion edhe Dekanëve të Fakulteteve dhe Përgjegjësve të Departamenteve (Ref. Nr. 8). Gjatë vizitës në institucion, GVJ iu konfirmua se për të ruajtur lirinë dhe etikën akademike, probleme të caktuara trajtohen individualisht me palët e interesuara.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit nga KSBC është përmirësimi i veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet evidentimit të mangësive dhe problematikave dhe marrjes së masave për rregullimin e tyre. Pavarësisht se studentët nuk janë diplomuar ende në këtë program studimi, institucioni ka kryer një raport paraprak vlerësimi (Ref. nr. 38). Në përfundim të raportin janë paraqitur edhe aktivitetet që duhet të ndërmerren për përmirësimin dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit, si: organizimi i takimeve informuese, sqaruese, dhe

	ndërgjegjësuere me grupe studentësh; takime e biseda gjysmë formale në institucione e organizata ku mendohet se ka interes për ndjekjen e këtyre programeve; përgatitje e materialeve informuese e sqaruese; organizimi logjistik e orientues “Javëve të regjistrimit”, gjatë të cilave të interesuarit informohen, sqarohen, këshillohen mbi sistemin e studimeve për ciklin e dytë, procedurat e aplikimit dhe të pranimit dhe pajisen me dokumentacionin përkatës; intensifikimi i bashkëpunimit me aktorët dhe institucionet e angazhuara gjatë vitit akademik.			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Kjo dëshmohej edhe nga Raporti Paraprak i Vlerësimit të programit MP “Audit” (Ref. Nr. 38).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Nëpërmjet përfshirjes në struktura këshilluese dhe vlerësuese (siç janë senati akademik, KSBC, GVB, këshilli i etikës, këshilli i studentëve etj.) UET informon dhe ndërgjegjëson stafin akademik, administrativ dhe studentët rreth sigurimit dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Gjatë takimit me pedagogë dhe student, GVJ iu komunikua se institucioni organizonte vazhdimisht veprimtari që informonin stafin dhe studentët në këtë drejtim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional "Audit", me profile, "Auditim dhe Menaxhim Risku", "Auditim i Institucioneve Financiare", "Kontabilitet dhe Raportim Financiar", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", "Administrim Publik"

a. Pikat e forta dhe afirmime;

1. Përfshirja e Institucionit në një gamë të gjerë projektsh me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Edhe programi i studimit MP në Audit është fryt i një projekti bashkëpunimi me bazë të gjerë, i financiar nga projekt i BE;
2. Infrastruktura e Institucionit është e pajisur me mjetet teknologjike të nevojshme për një proces mësimor interaktiv dhe me metoda inovative. Edhe stafi akademik paraqitet i përkushtuar për të përdorur infrastrukurën e një teknologjie të lartë të ofruar nga Institucioni;
3. Bashkëpunimi me institucione publike dhe organizata të biznesit në vend të cilat i afrojnë studentët edhe më tepër me tregun e punës dhe mundësojnë kryerjen e praktikave të suksesshme profesionale;
4. Sistemi i menaxhimit të informacionit midis sekretarisë mësimore dhe studentëve (UMIS) dhe midis studentëve dhe personelit akademik (LMS) mundëson një komunikim në kohë reale dhe lehtëson përçimin e njohurive të studentët;
5. Rrjet i pasur bashkëpunimi me Alumni-t e Institucionit. Kjo praktikë e mirë ka sjellë fryte të pasura, që nga përfshirja e Alumni-t në Bordin e Tregut të Punës, tek organizimi i eventeve me fokus Alumni-t e suksesshëm të Institucionit në vite, e deri tek rritja e imazhit;

b. Pika të dobta;

1. Studimi i tregut i kryer në kuadrin e projektit FINAC të BE nuk mbulon plotësisht programin e studimit MP në Audit me të gjitha profilet e tij, por vetëm një nga profilet (Administrim Publik). Pra, studimi i tregut nuk është kryer specifikisht për profesionin e auditimit në Shqipëri dhe nuk shtrihet përtej nevojave të administratës publike;
2. Nuk ka evidencë që programi i studimit para hapjes së tij të ketë marrë në konsideratë kërkesat specifike që ka profesioni i audituesit, si një profesion i rregulluar në Shqipëri, dhe në botë. Rrjedhimisht në fushën e vlerave morale, kodeve të etikës dhe qëndrimeve profesionale, të cilat konsiderohen prioritare për zhvillimin e profesionit të audituesit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (IES) konstatohet mbulim i

- pamjaftueshëm në lëndët bazë ose në lëndët ndërdisiplinore dhe integruese të programit të studimit;
3. Në Bibliotekë nuk gjenden tituj të mjaftueshëm për literaturë në fushën e Auditimit. Nga shqyrtimi i bërë për syllabuset e lëndëve të programit të studimit, konstatojmë që nga këto mungesa buron edhe përdorimi i terminologjisë të vjetëruar sidomos në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, terminologji e cila nuk është në përputhje me SKK të përmirësuara;
 4. Lëndën bazë të ofruar “Metoda kërkimi të avancuara” nuk e konsiderojmë në përputhje me synimin prioritar të programit të studimit. Duke qenë Master Profesional me synim aftësimin në profesion të studentëve, kjo lëndë bazë nuk përmbush synimin e këtij programi studimi;
 5. Dokumentacioni i paraqitur nga UET nuk sjell evidencë për qëndrueshmërinë financiare të institucionit në të ardhmen;

Rekomandime:

1. Përmirësimi i vijueshëm i programit të studimit MP në Audit për të konsideruar sa më shumë që të jetë e mundur kërkesat e certifikimit të profesionit të auditimit në Shqipëri dhe në botë, edhe përtej vecorive dhe nevojave për auditees të Administratës Publike;
2. Pasurimi në të ardhmen i kurrikulave nëpërmjet moduleve me zgjedhje, apo shtimi i temave të vecanta sidomos në elemente si etika, vlerat morale dhe qëndrimet profesionale, sipas specifikimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit, IES;
3. Shtimi i titujve të botimeve në fushën e auditimit të cilat të mund të depozitohen në Bibliotekën e Institucionit dhe të jenë botime të viteve sa më të fundit të cilat reflektojnë ndryshimet e ndodhura në këtë discipline;
4. Konsiderimi i një lënde bazë të ndryshme nga lënda “Metoda kërkimi të avancuara”; prezantimi i një lënde e cila të përmbushë një prej synimeve të këtij programi studimi i cili është aftësimi në profesion i studentëve do të përmirësonte njëkohësisht edhe kurrikulën e këtij programi studimi;
5. Informacioni financiar të mund të përpunohet dhe ofrohet në një mënyrë të tillë (të pakonsoliduar në kuadrin e grupit) që ta bëjë të lehtë vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare të vetë institucionit;
6. Të saktësohet dhe të përditësohet informacioni lidhur me programin e studimit MP në “Audit” në faqen zyrtare on-line të institucionit;

7. Nga analiza e përmbajtjes së njohurive brenda profileve, profili “Auditim dhe Menaxhim Risku” do të përfitonte ose nga pasurimi i syllabuseve të lëndëve ekzistuese, ose nga ndryshimi i ndonjëres prej lëndëve të ofruara me qëllim reflektimin më të mirë të emërtimit të profilit”;

Conclusions of the Evaluation Process of the study program “Professional Master in: "Audit", with profiles: "Audit and Risk Management", "Audit of Financial Institutions", "Accounting and Financial Reporting", "Project Management and Evaluation"; "Public Administration"

a. Strengths and affirmations

1. Engagement of the Institution in a wide range of projects with national and international partners is one of the strengths of the Institution. This specific study program Professional Master at Audit is also an outcome of a broad-based, EU-funded co-operation project;
2. The Institution's infrastructure is equipped with the technological tools needed for an interactive learning process and necessary for implementing innovative teaching methods. Academic staff also appears to be highly committed to use the technologically advanced infrastructure provided by the Institution;
3. Cooperation with public institutions and business organizations in the country offers the opportunity to bring students closer to the labor market and enables them to successfully carry out their professional activities according the market requirements;
4. The management information system between the teaching secretariat and students (UMIS) and between students and academic staff (LMS) enables communication in real time and facilitates the knowledge dissemination for students;
5. The Institution has built a strong collaboration network with its Alumni. This best practice has resulted in several initiatives which involve the Alumni such as their participation in the Labor Market Board of UET, the organization of events focusing on successful Alumni of the Institution over the years, and other activities focused to image enhancement;

b. Weaknesses:

1. The market study conducted in the framework the EU FINAC project does not fully cover the program “Professional Master in Audit” encompassing all of its profiles, but is rather

focused in only one of its profiles (e.g. Public Administration). Thus, the market study is not specifically conducted for the audit profession in Albania and does not extend beyond the needs of public administration;

2. There is no evidence that prior to the opening of this study program the Institution has considered the specific requirements of the auditor's profession, as a regulated profession in Albania and worldwide. Consequently, there is no sufficient coverage in the core subjects or in the interdisciplinary and integrative subjects of the study program of important topics such as, codes of ethics and professional attitudes and conducts, which are considered a priority for the development of the auditor's profession in accordance with International Standards of Education (IES);
3. In the Library of the Institution there is not found enough and adequate literature titles in the field of Audit. From the review of the syllabuses of the study program modules, we find that these deficiencies also contribute to the use of outdated terminology, especially in the area of accounting and financial reporting, terminology which is not in line with the improved National Accounting Standards;
4. The core subject "Advanced Research Methods" offered in this study program is not considered to be fully complying with the priorities and objectives of the study program. Being a Professional Master with the aim on the vocational training of students, this core subject does not accomplish the purpose of this study program;
5. The documentation submitted by UET does not provide evidence of the financial viability of the institution in the future;

Recommendations:

1. Continuous improvement of the study program "Professional Master in Audit" to take in consideration, to a greater extent, the certification requirements of the practicing auditing profession in Albania and worldwide;
2. Future improvement of the curricula through offering more elective modules, or through the addition in existing modules of specific topics, such as ethics, moral values and professional attitudes, as required by the International Standards of Education, IES;
3. The addition of most recently published textbooks and Journals in the field of auditing which may be deposited in the Institution's Library and be used by the students of the study program;

4. Taking into consideration a core module other than "Advanced research methods". Introduction of a course that helps students to achieve one of their primary goals which is initial professional development would improve the overall study program's curricula;
5. Financial information can be processed and reported in such a way (not consolidated with the financial information of the group) to make it easier to assess the financial viability of the institution itself;
6. Specify and update the information related to the study program Professional Master in "Audit" on the official website of the institution;
7. Based on the content analysis of the profiles of this study program, we suggest that the "Audit and Risk Management" profile would benefit either from the improvement of the syllabuses of the existing modules, or from the complete change of any of the existing courses in order for the curricula to better reflect the profile naming. We suggest either adding an interdisciplinary and integrative course, or simply enriching the existing syllabus with more topics focusing on the "Audit and Risk Management" profile;

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR				X

REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Gentiana SHARKU

Prof. Asoc. Dr. Rezarta SHKURTI

